



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*  
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*  
*Ministry of Local Government Administration*

---

## **ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I VETËQEVERISJES LOKALE NË KOSOVË**

*Gusht 2013, Prishtinë*

# PËRMBAJTJA

|   |           |
|---|-----------|
| <b>SHKURTESAT .....</b>   | <b>4</b>  |
| <b>PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE .....</b>                             | <b>5</b>  |
| <b>QASJA DHE METODOLOGJIA E PUNËS .....</b>                     | <b>7</b>  |
| <b>KORNIZA LIGJORE E VETËQEVERISJES LOKALE NË KOSOVË .....</b>  | <b>8</b>  |
| HISTORIKU .....   | 8         |
| BAZA LIGJORE PËR VETËQEVERISJEN LOKALE .....                    | 9         |
| <i>Parimet</i> .....  | 9         |
| <i>Rregullimi i sistemit të VQL</i> .....                       | 9         |
| <i>Rregullimi i bartjes së pushtetit</i> .....                  | 10        |
| <i>Struktura e bazës ligjore</i> .....                          | 10        |
| NDIKIMI I “PAKOS SË AHTISARIT” NË KORNIZËN LIGJORE .....        | 12        |
| LIGJI PËR VETËQEVERISJEN LOKALE .....                           | 13        |
| LIGJET E VEÇANTA DHE AKTET NËNLIGJORE .....                     | 16        |
| <i>Aktet komunale</i> .....                                     | 17        |
| <b>SISTEMI I VETËQEVERISJES LOKALE DHE DECENTRALIZIMI .....</b> | <b>18</b> |
| PARIMET E DEMOKRACISË LOKALE .....                              | 18        |
| DECENTRALIZIMI DHE REFORMA E PUSHTETIT LOKAL .....              | 18        |
| KOMPETENCAT E PUSHTETIT LOKAL .....                             | 22        |
| SISTEMI I VETËQEVERISJES LOKALE .....                           | 23        |
| <b>ORGANIZIMI I PUSHTETIT LOKAL .....</b>                       | <b>25</b> |
| ORGANIZIMI TERRITORIAL I KOMUNAVE .....                         | 25        |
| <i>Territori i komunave</i> .....                               | 26        |
| <i>Popullsia</i> .....  | 27        |
| <i>Pasuria natyrore</i> .....                                   | 28        |
| ORGANIZIMI I KOMUNAVE .....                                     | 29        |
| <i>Zgjedhjet lokale</i> .....                                   | 29        |
| KUVENDI I KOMUNËS .....   | 29        |
| KRYETARI I KOMUNËS .....  | 31        |
| ADMINISTRATA KOMUNALE .....                                     | 31        |
| <b>OFRIMI I SHËRBIMEVE .....</b>                                | <b>33</b> |
| SHËRBIMET QË OFRON KOMUNA .....                                 | 33        |
| SHËRBIMET THEMELORE .....                                       | 33        |
| <i>Shërbimet administrative</i> .....                           | 34        |
| <i>Menaxhimi i financave lokale</i> .....                       | 34        |
| <i>Zhvillimi ekonomik lokal</i> .....                           | 35        |
| <i>Transporti Publik</i> .....                                  | 36        |
| <i>Kushtet në mjediset urbane dhe rurale</i> .....              | 36        |
| <i>Menaxhimi i tokës dhe zhvillimi i bujqësisë</i> .....        | 36        |
| <i>Zbatimi i standardeve të ndërtimit</i> .....                 | 39        |
| <i>Mbrojtja e mjedisit</i> .....                                | 39        |

|  |           |
|--|-----------|
| <i>Shërbimet publike dhe komunale</i> .....                          | 39        |
| <i>Menaxhimi i emergjencave</i> .....                                | 41        |
| <i>Ofrimi i shërbimeve arsimore</i> .....                            | 41        |
| <i>Ofrimi i shërbimeve shëndetësore</i> .....                        | 42        |
| <i>Promovimi dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut</i> .....         | 42        |
| <i>Ofrimi i shërbimeve familjare dhe të mirëqenies sociale</i> ..... | 43        |
| <i>Rinia kultura dhe turizmi</i> .....                               | 43        |
| <i>Mbrojtja e trashëgimisë kulturore</i> .....                       | 44        |
| <i>Regjistrimi dhe licencimi i bizneseve</i> .....                   | 44        |
| <b>SHËRBIMET E TRANSFERUARA</b> .....                                | 45        |
| <b>SHËRBIMET E SHITESË</b> .....                                     | 45        |
| <b>KAPACITETET E KOMUNAVE</b> .....                                  | 45        |
| <b>PERFORMANCA E KOMUNAVE NË OFRIMIN E SHËRBIMEVE</b> .....          | 46        |
| <b>BASHKËPUNIMI NDËRKOMUNAL</b> .....                                | <b>47</b> |
| <b>BASHKËPUNIMI NDËRKOMUNAL VENDOR</b> .....                         | 47        |
| <i>Asociacioni i komunave</i> .....                                  | 48        |
| <b>BASHKËPUNIMI NDËRKOMUNAL NDËRKOMBËTAR</b> .....                   | 48        |
| <b>MARRËDHËNIET NDËRMJET QEVERISË LOKALE DHE QENDRORE</b> .....      | 49        |
| <b>MBIKËQYRJA DHE KONTROLLI</b> .....                                | <b>51</b> |
| <b>KUPTIMI I MBIKËQYRJES DHE I KONTROLLIT</b> .....                  | 51        |
| <b>LLOJET E MBIKËQYRJES DHE KONTROLLIT</b> .....                     | 52        |
| <b>MBIKËQYRJA DHE KONTROLLI I BRENDSHËM</b> .....                    | 52        |
| <i>Kontrolli i kuvendit ndaj ekzekutivit</i> .....                   | 53        |
| <i>Kontrolli i hartimit të politikave komunale</i> .....             | 54        |
| <i>Kufizimet ligjore në procesin e mbikëqyrjes</i> .....             | 54        |
| <i>Shfuqizimi i akteve të paligjshme komunale</i> .....              | 55        |
| <i>Kontrolli i administratës</i> .....                               | 55        |
| <i>Inspektimi</i> .....  | 56        |
| <i>Auditi i brendshëm</i> .....                                      | 57        |
| <b>MBIKËQYRJA E KOMUNAVE NGA AUTORITETET QENDRORE</b> .....          | <b>57</b> |
| <i>Monitorimi i komunave nga MAPL</i> .....                          | 58        |
| <i>Monitorimi on-line i komunave</i> .....                           | 59        |
| <i>Komisionet ndërministrrore</i> .....                              | 60        |
| <i>Efikasiteti i organit mbikëqyrës</i> .....                        | 60        |
| <b>SHTOJCA</b> .....   | <b>61</b> |

## SHKURTESAT

|              |   |
|--------------|---|
| <b>AKK</b>   | Agjencioni Kadastral i Kosovës                              |
| <b>AZHR</b>  | Agjencionet Zhvillimore Rajonale                            |
| <b>BE</b>    | Bashkimi Evropian   |
| <b>BNK</b>   | Bashkëpunim Ndërkufitar                                     |
| <b>BNj</b>   | Burime Njerëzore  |
| <b>DPSA</b>  | Dialogu për Procesin e Stabilizim Asocimit                  |
| <b>EURED</b> | Projekti i Bashkimit Evropian për Zhvillim Ekonomik Rajonal |
| <b>EQL</b>   | Evropës Qendrore dhe Lindore                                |
| <b>IKAP</b>  | Instituti i Kosovës për Administratë Publike                |
| <b>IPVQ</b>  | Institucionet e Përkohshme Vetëqeverisëse                   |
| <b>GAP</b>   | Instituti për Studime të Avancuara                          |
| <b>GIZ</b>   | Bashkëpunimi Gjerman për Zhvillim                           |
| <b>KE</b>    | Komisioni Evropian  |
| <b>KEVL</b>  | Karta Evropiane për Vetëqeverisje Lokale                    |
| <b>KQZ</b>   | Komisioni Qendror Zgjedhor                                  |
| <b>LFL</b>   | Ligji për Financat e Pushtetit Lokal                        |
| <b>LKAK</b>  | Ligji për Kufijtë Administrativ                             |
| <b>LVL</b>   | Ligji për Vetëqeverisje Lokale                              |
| <b>LZL</b>   | Ligji për Zgjedhje Lokale                                   |
| <b>MAP</b>   | Ministria e Administratës Publike                           |
| <b>MAPL</b>  | Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal                |
| <b>MASHT</b> | Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë              |
| <b>MIE</b>   | Ministria e Integriteteve Evropiane                         |
| <b>MKRS</b>  | Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit                    |
| <b>MPB</b>   | Ministria e Punëve të Brendshme                             |
| <b>OJQ</b>   | Organizatë Jo Qeveritare                                    |
| <b>OKB</b>   | Organizata e Kombeve të Bashkuara                           |
| <b>OSCE</b>  | Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian              |
| <b>PA</b>    | Pakoja e Ahtisarit  |
| <b>PQ</b>    | Pushteti Qendror  |
| <b>PVMSA</b> | Plani i Veprimit për Marrëveshjen e Stabilizim Asocimit     |
| <b>RAE</b>   | Komuniteti Rom, Ashkali, Egjiptas                           |
| <b>RFVL</b>  | Rishikimi Funksional i Vetëqeverisjes Lokale                |
| <b>SVQ</b>   | Sistemi Vetëqeverisjes Lokale                               |
| <b>UNDP</b>  | Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim                |
| <b>UNMIK</b> | Misioni i Administratës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë   |
| <b>USAID</b> | DEMI - Iniciativa për Komuna Demokratike dhe Efektive       |
| <b>VL</b>    | Vetëqeverisja Lokale  |
| <b>ZAMV</b>  | Zyra Administrative e Mitrovicës Veriore                    |
| <b>ZCN</b>   | Zyra Civile Ndërkombëtare                                   |
| <b>ZKM</b>   | Zyra e Kryeministrit  |

## PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

Trendi i zhvillimeve politike, ekonomike dhe shoqërore në botë, kohëve të fundit është duke rrjedhë në dy kahje të kundërta, në njërën anë drejt globalizimit dhe në anën tjetër drejt lokalizimit. Kjo lëvizje e gjithëmbarshme e shoqërisë njerëzore ka ndikuar në masë të madhe edhe në ndryshimet e sistemeve të qeverisjes, ne veçanti të qeverisjes lokale. sendërtimi i koncepteve politike për mbrojtjen dhe afirmimin e të drejtave të njeriut, në veçanti krijimi i sistemeve konkurruese demokratike të ekonomisë së tregut në shërbim të rritjes së mirëqenies së qytetarëve të një vendi, ka krijuar parakushtet për zhvillime të hovshme të sistemeve politike dhe administrative në shërbim të qytetarëve. Secili vend në botë sot e ka pranuar decentralizimin si instrument politik demokratik për ta zbritë pushtetin e centralizuar të vendit sa më afër qytetarëve të vetë.

Që nga viti 1999, kur Kosova u vendos nën protektoratin ndërkombëtar, ajo u ballafaqua dhe u sfidua nga tranzicione të shumëfishta, tre prej të cilave ishin kryesore për zhvillimin socio - ekonomik dhe për qeverisje të mirë në vend, si: transformimi prej sistemit politik autoritar në atë demokratik; kalimi prej një ekonomie të planifikuar shtetërore në ekonominë e tregut dhe bartja e pushtetit prej strukturave të përkohshme të UNMIK në institucionet e pavarura të Kosovës. Klasa politike e Kosovës ka qenë e përkushtuar në procesin e ndërtimit të një sistemi qeverisës, i cili në veti bartë vlerat dhe standardet më të përparuara të demokracisë perëndimore të shprehura nëpërmjet politikave të përshtatshme, reformës institucionale dhe zbatimit të marrëveshjeve shumëpalëshe për zhvillimin e vendit. Në këtë drejtim janë arritur shumë suksese në ndërtimin e një sistemi demokratik politik, në krijimin e një baze solide për zhvillimin e ekonomisë së tregut të bazuar në konkurrencë dhe në bartjen e pushtetit nga autoritetet ndërkombëtare në ato vendore, ku më 17 shkurt 2008 Kosova shpalli pavarësinë e saj. Ndërkaq ndërtimi i sistemit demokratik të decentralizuar të vetëqeverisjes lokale është përcjellë me vështirësi të ndryshme politike dhe të burimeve financiare e njerëzore. Ishte një proces shumë i ndjeshëm, i ndërlikuar dhe nganjëherë i paqëndrueshëm, por që ka rezultuar i suksesshëm. Si pasojë e zhvillimeve politike në vend, komunat veriore të Kosovës ende nuk janë integruar në sistemin e VQL, ndërsa pjesa më e madhe e komunitetit serb është i përfshirë në jetën politike të vendit.

Ndërtimi dhe zhvillimi i sistemit të vetëqeverisjes lokale (SVQL) u bazua në parimet e vlerave evropiane për qeverisje lokale, por duke ia përshtatë nevojave dhe zhvillimeve politike të vendit. Derisa në shumicën e vendeve të rajonit dhe më gjerë ndërtohen sisteme duele të vetëqeverisjes lokale, Kosova zgjodhi sistemin e thjeshtë një shkallësh të VQL. Ky sistem përfaqësohet vetëm nga të zgjedhurit e qytetarëve të komunës përkatëse dhe pushteti qendror (PQ) nuk emëron përfaqësuesit e vetë në bashkëqeverisje. Qytetarët vullnetin për udhëheqjen e tyre për një mandat prej 4 vjetëve e delegojnë në

dy organe të pushtetit lokal (PL): në kuvendin e komunës dhe në kryetarin e komunës. Decentralizimi i pushtetit dhe ndërtimi i sistemit për vetëqeverisje lokale nuk u përcoll edhe me gjenerimin e të hyrave vetanake të nevojshme për zhvillimin ekonomik lokal, por në masën më të madhe (82%), buxheti i komunave është ende i varur nga buxheti Kosovës.

Ndryshimi i sistemit parlamentar të zgjedhjes së kryetarit të komunës në sistemin e zgjedhjes së drejtpërdrejt nga qytetarët, i ka dhënë të drejta dhe përgjegjësi më shumë kryetarit të komunës, por në të njëjtën kohë e ka krijuar sistemin e VQL me dy komanda relativisht të pavarura. Kjo e ka lehtësuar vendimmarrjen e organeve komunale, por vetëqeverisjen lokale e orienton më shumë kah autonomia lokale ku pushtetet janë të ndara, ngjashëm sikur në nivelin qendror. Në fakt sistemi i zgjedhjes së organeve të PL është i njëjtë me sistemin e zgjedhjeve presidenciale dhe parlamentare në nivelin qendror.

Korniza aktuale ligjore i ka dhënë një autonomi të plotë organeve të PL. Decentralizimi i pushtetit, reforma e pushtetit lokal duke fituar një shkallë të lartë të autonomisë në qeverisjen e komunave, ka ndikuar në integrimin e komunitetit serb dhe krijimin e një politike stabile dhe të unifikuar në vend. Kështu sistemi i ka arritur tre objektiva kryesore: 1) krijimin e shtetit me një shoqëri të qëndrueshme multi-etnike; 2) integrimin e komuniteteve (në veçanti të komunitetit serb) në institucionet vetëqeverisëse të vendit dhe 3) ofrimin e shërbimeve cilësore për qytetarët. Qytetarët kanë të drejta të barabarta, që vetë t'i zgjedhin përfaqësuesit e tyre për t'i qeverisur dhe për t'iu shërbyer atyre dhe po ashtu për t'i shkarkuar nëse nuk qeverisin mirë me pasuritë e tyre. Pra pushteti i vetëqeverisjes lokale buron vetëm nga vullneti i qytetarëve, duke përjashtuar çdo mundësi të ndërhyrjes nga lartë, me përjashtim të gjykatave kompetente kur organet e PL e shkelin ligjin. Megjithatë institucionet qendrore, pa mbështetje ligjore, kanë ndërtuar struktura administrative ndërmjet PL dhe atij qendror duke dashtë që t'iu ofrojnë ndihmë PL në ofrimin e shërbimeve sa më cilësore për qytetarët.

Reformat e SVQL, me qëllim të arritjes së tre objektivave strategjike, kanë përfshi edhe riorganizimin territorial të komunave duke mundësuar krijimin e komunave të reja, kryesisht me shumicë serbe. Kjo i mundësoi komunitetit serb që të jetë shumicë në vendimmarrje në territorin e vetë gjë e cila bëri të mundur integrimin e tyre në institucionet politike të vendit. Krijimi i komunave të reja sipas parimit "ofrimi i shërbimeve sa më afër qytetarit" po vazhdon edhe për komunitetin shumicë dhe nga njëherë po merr më shumë konotacion politik se sa nevojë për qytetarët.

## Qasja dhe Metodologjia e Punës

Grupi punues, fillimisht, ka hartuar planin e veprimit, ku janë ndarë detyrat dhe burimet e nevojshme për përmbushjen e punës. Mbi bazën e planit, ka bërë mbledhjen e të dhënave, nga burime të ndryshme dhe, sa më relevante me objektin e hulumtimit të dokumentit. Për fusha të caktuara, ku kanë munguar informatat e bollshme, grupi punues nga zhvilluar instrumente specifike për mbledhjen e informatave parësore, si: pyetësor, intervista etj. Të dhënat janë klasifikuar në bazë të fushave përkatëse të hulumtimit, nga ana e anëtarëve të grupit. Secili anëtar i grupit ka qenë përgjegjës për një grup të fushave të caktuara dhe ka punuar mbi bazën e një metodologjie, paraprakisht të përcaktuar.

Shkrimi i dokumentit është bërë në bazë të një strukture të planifikuar paraprakisht, e cila ka mundësuar që, të dhënat të shprehin gjetjet thelbësore të shkallës së funksionimit apo të mos funksionimit të strukturave dhe proceseve të caktuara të vetëqeverisjes lokale, në bazë të krahasimit të gjendjes së ndryshuar nëpër vite. Kjo do të thotë se fillimisht është përshkruar situata e një funksioni përkatës të komunës, në vitet paraprake, e cila gjendje është shfrytëzuar si referencë e krahasimit me zhvillimet e më vonshme. Krahasimi i të dhënave, që kanë pasqyruar gjendjen e caktuar të funksionimit të PL, është bërë edhe me dispozitat përkatëse të ligjeve të zbatueshme dhe praktikave të ngjashme të vendeve të ndryshme të Evropës.

**Kriteret e vlerësimit.** Vlerësimi i funksionimit të VQL, është bërë në bazë të kriterëve të brendshme dhe të jashtme. Kriter i brendshëm është shfrytëzuar: përcaktimi i standardeve të punës në komunë, shkalla e organizimit dhe e menaxhimit funksional të komunës, shkalla e bashkërendimit me pushtetin qendror, niveli i zhvillimit ekonomik e shoqëror lokal dhe kapacitetet menaxhuese të komunës. Si kriter i jashtëm është shërbyer qëllimi i këtij vlerësimi në funksion të përmbushjes së kërkesave të qytetarëve.

### **Grupi për hartimin e këtij dokumenti, kishte këtë përbërje:**

- Isuf Zeneli, udhëheqës i grupit punues;
- Shkëlqim Jakupi, anëtar i grupit;
- Ferdi Kamberi, anëtar i grupit;
- Diellor Gashi, anëtar i grupit;
- Mimoza Bajraktari, përpunimi i të dhënave;
- Agron Maxhuni, konsultat për çështje ligjore;
- Besim Kamberaj konsultat për çështje të financave;
- Dugagjin Etemi, konsultat për çështje ekonomike lokale dhe ofrim të shërbimeve;
- Xhevat Tafa, konsultat për çështje të monitorimit
- Ismail Halili, konsultat për çështje të auditimit dhe
- Venera Kosumi, konsultat për integritet evropiane.

# KORNIZA LIGJORE E VETËQEVERISJES LOKALE NË KOSOVË

## Historiku

Shekulli i 20 konsiderohet si promotori i krijimit të përparësive në qeverisjen lokale në botë. Reformat e vazhdueshme në përpjekjen e krijimit të sistemeve të përparuara të qeverisjes lokale kanë qenë kontribut i hulumtimeve të vazhdueshme gjatë shekullit të kaluar dhe në fillim të shekullit 21. Elaborimi i Kartës Evropiane për Vetëqeverisje Lokale ka qenë i lidhur ngushtë me garantimin e të drejtave të komuniteteve dhe përfaqësuesve të tyre<sup>1</sup> me rastin e delegimit të autoritetit nga niveli qendror në atë lokal. Në përputhje me këto parime, filloi reforma e pushtetit lokal në Kosovë. Reforma filloi në vitin 1999/2000, pas përfundimit të luftës në Kosovë dhe vendosjes së Administratës së UNMIK-ut. Fillimisht, organizimi dhe funksionimi i pushtetit lokal u rregullua me Rregulloren të UNMIK – ut, që kishin fuqi ligjore dhe pastaj me ligj dhe kushtetutë në vitin 2008.

Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2000/45 Mbi Vetëqeverisjen e Komunave të Kosovës ishte akti i parë rregullativ me fuqi ligjore që vendosi themelet e një sistemi të vetëqeverisjes lokale demokratike dhe në shërbim të qytetarëve në shtetin e Kosovës. Me këtë rregullore themelohet baza juridike e sistemit të vetëqeverisjes lokale në përputhje me parimet dhe praktikën demokratike evropiane.

Nga viti 1999 e deri në vitin 2010, janë nxjerrë shumë rregullore të UNMIK me fuqi ligjore, ligje organike, ligje sektoriale dhe udhëzime administrative, të cilat i kanë dhënë një autonomi gjithnjë e më të madhe pushtetit lokal në Kosovë. Ndërsa, menjëherë pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, në shkurt të vitit 2008, Kuvendi i Republikës së Kosovës i miratoi ligjet e reja kryesore për vetëqeverisjen lokale, të cilat kanë zëvendësuar legjislacionin e deri atëherëshëm.

Zhvillimi i kornizës ligjore për vetëqeverisjen lokale në Kosovë mund të ndahet në tri periudha kohore:

1. Periudha e administrimit të komunave me Administrator komunal, sipas Rregullativave të UNMIK-ut, nga viti 2000 deri më 2002;
2. Periudha e administrimit të komunave pa administrator komunal sipas Rregulloreve të UNMIK-ut dhe akteve tjera ligjore të IPVQ, me transferim të kompetencave në organet e vetëqeverisjes lokale, gradualisht nga viti 2002 deri më 2007
3. Periudha e vetëqeverisjes lokale sipas Kushtetutës dhe Ligjeve të miratuara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, nga 2008 deri sot.

---

<sup>1</sup> Council of Europe Publishing: “*European Charter of Local Self – Government*”, March 2010, pg. 9.



Duke u bazuar në këto të dhëna, mund të konstatojmë se aktet bazike ligjore për ndërtimin, organizimin dhe funksionimin e sistemit të vetëqeverisjes lokale në Kosovë, janë nxjerrë nga UNMIK (1999 - 2007, *shih shtojca 1*) dhe nga Kuvendi i Republikës së Kosovës (2008 - 2012).

## **Baza Ligjore për Vetëqeverisjen Lokale**

### Parimet

Korniza ligjore për VQL është e bazuar në parimet e Kushtetutës së Kosovës dhe të Kartës Evropiane për Vetëqeverisje Lokale (KEVL). Me nenin 123 të Kushtetutës, pika 4 janë caktuar parimet bazë të vetëqeverisjes lokale në Kosovë, si: qeverisja e mirë, transparenca, efikasiteti dhe efektiviteti në ofrimin e shërbimeve publike, duke u kushtuar kujdes të veçantë nevojave të komuniteteve të cilat nuk janë shumicë dhe pjesëtarëve të tyre<sup>2</sup>.

### Rregullimi i sistemit të VQL

Ndërtimit dhe funksionimit të sistemit të VQL, në përgjithësi, i ka parapri një bazë ligjore me anë të cilës janë përcaktuar parimet dhe standardet e rregullimit dhe funksionimit të përgjithshëm të sistemit. Kompetencat bazë dhe përgjegjësitë e autoriteteve lokale përcaktohen me kushtetutë dhe me ligj. Kjo dispozitë nuk ndalon që autoriteteve lokal t'iu atribuohen kompetenca dhe përgjegjësi për qëllime të posaçme, në përputhje me ligjin<sup>3</sup>. Me kornizën ligjore vetëqeverisja lokale në Kosovë është përcaktuar si e drejtë e autoriteteve lokale për të menaxhuar një pjesë të shërbimeve publike që janë në interes të popullatës lokale. Baza ligjore u krijua dhe u zhvillua, fillimisht, nga autoritetet ndërkombëtare (UNMIK) dhe pastaj nga autoritetet e Republikës së Kosovës.

Me kornizën ligjore janë përcaktuar shtyllat e organizimit, funksionet, të drejtat, obligimet dhe mbikëqyrja e organeve komunale. *Nga viti 2008, Kushtetuta e Republikës së Kosovës përfaqëson bazën themelore ligjore për ndërtimin dhe funksionimin e VQL në Kosovë.*

Po ashtu në bazë të dispozitave të nenit 123 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, komuna përfaqëson nivelin e vetëm të pushtetit dhe njësinë themelore, ndërtuese dhe funksionale të vetëqeverisjes lokale me pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje. Përcaktimi i këtij lloji të PL ka për qëllim eliminimin e tendencave për përfaqësim të ndryshëm të qytetarëve në procesin e vendimmarrjes.

---

<sup>2</sup> Kuvendi i Kosovës: “Kushtetuta e Republikës së Kosovës”, Prill 2008, kapitulli X, neni 123, pika 4.

<sup>3</sup> Council of Europe Publishing: “European Charter of Local Self – Government”, neni 4, pika 1.

Përgjithësisht, korniza ligjore për qeverisjen lokale u zhvillua në harmoni të plotë me Rregulloren e UNMIK Nr. 45/2000, pastaj me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me LVL. Korniza ligjore u zhvillua në përputhje me nevojën e bartjes së kompetencave në pushtetin lokal dhe përgjithësisht nuk janë vërejt konfliktet funksionale brenda kornizës. Mund të themi se fillimisht të drejtat dhe përgjegjësitë e autoriteteve lokale, të përcaktuara me rregulloret e UNMIK - ut, kanë qenë më pak autonome se sa kompetencat e përcaktuara me vonë me ligjet e miratuara nga autoritetet e Republikës së Kosovës (2008). Kjo do të thotë se me kalimin e kohës autoritetet lokale, me kornizën e re ligjore, fituan më shumë kompetenca dhe në të njëjtën kohë edhe më shumë autonomi të qeverisjes.

Me rregullore ishin përcaktuar qartë kompetencat dhe përgjegjësitë e pjesës politike të sistemit (kuvendit dhe kryetarit të komunës) dhe pjesës ekzekutive, që ishin në përputhje edhe me rregulloret tjera organike për shërbimin civil në administratën publike. Me Ligjin e Vetëqeverisjes Lokale u qartësuan dhe u avancuan edhe më shumë kompetencat e kryetarit të komunës, por u bë një ndërhyrje e emërimeve politike në administratën e komunës, që nuk është në përputhje me ligjet tjera organike në administratën shtetërore të Kosovës.

### Rregullimi i bartjes së pushtetit

Korniza ligjore krijon një bazë të fort për decentralizim të pushtetit në organet e VQL. Ajo ka krijuar mundësinë e bartjes së më shumë kompetencave se sa që komunat kanë pas kapacitete. Kështu ajo krijoi kushte të veçanta ligjore për krijimin e komunave të reja me shumicë serbe. Ndërkaq për disa komuna të vogla ekzistuese kompetencat e deleguara nuk u ndihmuan shumë në ushtrimin e tyre. Kjo ka krijuar, në disa raste, decentralizim të tepërt dhe të kthyeshëm. Korniza në njërin kahje ka krijuar mundësinë e decentralizimit të sistemit, ndërsa në kahjen tjetër, ministritë e linjës dhe qeveria e kanë zhvilluar legjislacionin e tyre, për disa segmente të qeverisjes, në mospërputhje me parimet dhe standardet e LVL. Zhvillimi dykahor i legjislacionit ka ndikuar që në njërin anë të decentralizohen të drejtat dhe përgjegjësitë e PL dhe në anën tjetër është bërë centralizimi i tyre nëpërmjet mekanizmave ligjor dhe strukturave organizative ndërsektoriale.

### Struktura e bazës ligjore

Organizimi dhe funksionimi i vetëqeverisjes lokale rregullohet me ligje organike, me ligje të veçanta (speciale) dhe me akte tjera nënligjore të miratuara nga niveli qendror dhe ai lokal. Ligjet organike kanë përcaktuar të drejtat dhe përgjegjësit (normat) e përgjithshme të institucioneve lokale në përputhje të plotë me parimet e Kushtetutës së Republikës së Kosovës (RK). Ligjet e veçanta (speciale) i kanë specifikuar të drejtat dhe përgjegjësitë e përgjithshme të përcaktuara me ligjet organike, të punës së organeve të

VQL në fushat e rëndësishme dhe të veçanta të tyre. Po ashtu, për fushëveprimtaritë e caktuara shumë specifike, janë nxjerrë udhëzime të ndryshme administrative (UA). Në këtë mënyrë autoritetet qendrore të vendit i kanë sanksionuar politikat shtetërore të vendit me ligje dhe UA ndërsa autoritetet lokale i kanë sanksionuar politikat e zhvillimit lokal me akte komunale nënligjore. Organet e VQL kanë të drejtë të miratojnë akte komunale me interes të përgjithshëm dhe të vecantë për komunën përkatëse, por në përputhje të plotë me kornizën ligjore të VQL dhe të ligjeve tjera në fuqi në Republikën e Kosovës. *Të gjitha ligjet sektoriale që kanë të bëjnë me Pl duhet të jenë në përputhje të plotë me LVL.*

Në përputhje me frymën e LVL dhe të ligjeve tjera organike janë miratuar ligje sektoriale apo speciale për të rregulluar funksionimin e plotë të sistemit të VQL. Ligjet dhe aktet tjera juridike kanë një shtrirje horizontale dhe vertikale. Kjo do të thotë që, për të funksionuar mirë sistemi i VQL, nevojitet harmonizim i plotë i tyre si në dimensionin horizontal po ashtu edhe në atë vertikal. Në përputhje me këto parime, Kuvendi i Kosovës dhe komunat i kanë miratuar legjet dhe aktet komunale për VQL. Kjo hierarki e organizimit të kornizës ligjore ka pas për qëllim ndërtimin e një sistemi juridik ku sundon rregulli dhe ligji, ku secili është përgjegjës dhe llogaridhënës për punën e institucionit në përgjithësi dhe të bartësve të punës në veçanti.

Në këtë pikëpamje komunat kanë probleme lidhur me funksionimin e bizneseve në komuna për dy arsye, Ligji për Financat e Pushtetit Lokal ju mundëson komunave të inkasojnë te hyra nga taksat për lejen dhe ushtrimin e veprimtarisë afariste, ndërsa Ligji për Tregti të Brendshme ju ndalon komunave të inkasojnë te hyra nga regjistrimi bizneseve. Kjo kundërthënie e ligjeve e ka sjellë sistemin jashtë funksionit. Komisioni për vlerësim të akteve nënligjore i komunave në fushën e financave, konkretisht të rregulloreve për tarifa, ngarkesa dhe gjoba, ka kërkuar interpretim ligjor nga DL në MAPL dhe DL në MF për këtë çështje por nuk kanë marrë ende përgjigje<sup>4</sup>.

Po ashtu është konstatuar se komunat gjatë miratimit të akteve komunale nuk i kanë zbatuar gjithëherë ligjet dhe për pasojë janë nxjerrë akte komunale në kundërshtim me legjislacionin në fuqi. MAPL është kujdesur që të krijoj mekanizma të nevojshëm ligjor për mbrojtjen e ligjshmërisë në punën e komunave. Në bazë të analizave të bëra është konstatuar se këta mekanizma nuk janë mjaftë të fuqishëm për parandalimin e shkeljeve ligjore nga ana e komunave.

Derisa rregulloret e UNMIK, i kishin kufizimet e veta si rregullore, legjislacioni i ri u krijua gjithashtu në kuadër të përcaktimve të Pakës së Ahtisarit (PA). Politikat e Qeverisë, të cilat morën obligime ndërkombëtare me rastin e shpalljes së Pavarësisë së

---

<sup>4</sup> Begolli, Fetije “Zyrtare e lartë për Menaxhimin e Buxheteve Komunale në MAPL”, Prishtinë, 07.08.2013.

Kosovës, u përkthyen në kornizë ligjore për ndërtimin e një sistemi të qeverisjes lokale me kompetenca politike shtesë për komunitetin serb.

## **Ndikimi i “Pakos së Ahtisarit” në Kornizën Ligjore**

Procesit të hartimit dhe të miratimit të aktit më të lartë juridik dhe politik të vendit, Kushtetutës së Republikës së Kosovës, i ka paraprirë Propozimi Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës apo Pakoja e Ahtisarit. Pakoja e Ahtisarit vjen si rezultat i bisedimeve politike me Serbinë, të ndërmjetësuara nga faktori ndërkombëtar, me anë të cilës Kosova merr përgjegjësi të caktuara në raport me mënyrën e rregullimit shtetëror të vendit dhe ndaj komunitetit serb. Me këtë Marrëveshje Kosova fiton përkrahjen ndërkombëtare për shpalljen e Pavarësisë së saj më 17 shkurt 2008. Në përputhje me frymën e marrëveshjes dhe me kërkesat politike të popullit të Kosovës, me 09 prill 2008 miratohet Kushtetuta e cila hynë në fuqi më 15 qershor 2008. Kushtetuta e përcakton Republikën e Kosovës shtet të pavarur, sovran, demokratik, unik dhe të pandashëm<sup>5</sup>. Dispozitat e kushtetutës, të cilat përcaktojnë shtyllat kryesore të organizimit dhe funksionimit të vetëqeverisjes lokale, janë të bazuara kryesisht në parimet e Kartës Evropiane për Vetëqeverisjen Lokale (KEVL) dhe në kërkesat që dalin nga Pakoja e Ahtisarit (PA). Kërkesat e PA kanë ndikua në masë të madhe në përcaktimin e disa standardeve shtesë të sistemit të VQL e që kanë të bëjnë me të drejtat dhe përgjegjësitë e komunitetit serb. Korniza ligjore këto të drejta i ka sanksionuar me dispozita të përgjithshme dhe të veçanta dhe që kanë ndikuar në krijimin e dallimeve pozitive ndërmjet qytetarëve në favor të komunitetit serb.

Ndikimi i frymës së PA në zhvillimin e kornizës ligjore dhe të sistemit të VQL në përgjithësi, ka pas për qëllim që të krijojë një sistem shumë fleksibil dhe politikisht të qëndrueshëm duke siguruar pjesëmarrjen e të gjitha komuniteteve në qeverisjen lokale. Kjo ka ndikuar që të krijohet një sistem i hapur i qeverisjes dhe jo shumë llogaridhënës. Kosova si shihet është e orientuar në qeverisjen e mirë, në plotësimin e nevojave të qytetarëve dhe në integrimin e plotë të komuniteteve në institucionet e qeverisjes lokale. Krijimi i kushteve politike dhe juridike për integrimin e komunitetit serb në institucionet lokale nëpërmjet të cilit proces janë krijuar kushtet për stabilitetin politik të vendit, ka qenë parësore në zhvillimin e kornizës ligjore.

---

<sup>5</sup> Kuvendi i Kosovës: “Kushtetuta e Republikës së Kosovës”, Prill 2008, kapitulli I, neni 1.

Me qëllim të përparimit dhe afirmimit të të drejtave të komuniteteve, legjislacioni parasheh dy gjuhë zyrtare, ndërsa në nivelin lokal pos gjuhëve zyrtare kemi edhe gjuhët ne përdorim zyrtar dhe gjuhët tradicionale të përdorura nga komunitetet pakicë, që nuk mund t'i hasim në vendet tjera, në këtë nivel. Komuniteteve me ligj u njihet e drejta për pozitën e garantuar të Zëvendës-kryesuesit për Komunitete në Kuvendin e Komunës si dhe Nënkryetarit të Komunës për Komunitete, në ato komuna ku popullsia e tyre është 10% apo më shumë<sup>6</sup>.

Ndikimi i obligimeve nga marrëveshjet ndërkombëtare në raport me komunitetin serb mund të ndikoi, që Kosova të hyjë prapë në rishikimin e kornizës së saj ligjore dhe rregullimin e vetëqeverisjes lokale në përgjithësi.

Korniza ligjore, nga rregulloret e UNMIK deri tek legjislacioni aktual, karakterizohet me një zhvillim drejt krijimit të një sistemi të qëndrueshëm me përfshirje të të gjitha komuniteteve në procesin e vendimmarrjes dhe të ofrimit sa më cilësor të shërbimeve ndaj qytetarëve dhe grupeve të interesit. E gjithë kjo nëpërmjet forcimit të autonomisë lokale.

## **Ligji për Vetëqeverisjen Lokale**

Në përputhje me parimet e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Kartës Evropiane për Vetëqeverisje Lokale dhe “Pakos së Ahtisarit”, Kuvendi i Republikës së Kosovës ka miratuar LVL, si ligj organik apo themelor për organizimin dhe funksionimin e VQL në Kosovë. Ligji i cakton normat dhe standardet për një VQL e cila bazohet në 4 shtylla kryesore:

- Demokracia lokale (zgjedhja e organeve komunale);
- Pushteti i autoriteteve lokale (autonomia lokale)
- Organizimi dhe funksionimi i SVQ
- Mbikëqyrja e autoriteteve lokale

Ligji përcakton një model të përfaqësimit proporcional politik në vendimmarrje, si parim i demokracisë lokale. Ky përfaqësim bëhet drejtpërdrejt nga qytetarët në dy organe kryesore të VQL, kuvendi i komunës dhe kryetari i komunës. Derisa parimi themelor i vetëqeverisjes lokale është përfaqësimi i barabart i qytetarëve në vendimmarrje, me këtë ligj dhe me ligjin për zgjedhjet lokale, duke e përcaktuar komunën vetëm një zonë zgjedhore, qytetarëve u mundësohet përfaqësim proporcional vetëm nëpërmjet partive

---

<sup>6</sup> Kuvendi i Kosovës: “*Ligji Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale*”, Nenet 54 dhe 61.

politike dhe iniciativave të qytetarëve, por jo edhe të vetë qytetarëve. Ndërkaq qytetarëve iu është mundësuar që të marrin pjesë në vendimmarrje të drejtpërdrejt nëpërmjet iniciativave të qytetarëve dhe referendumit<sup>7</sup>. Me ligj janë përcaktuar mekanizmat e demokracisë lokale, si: *zgjedhjet lokale, referendumi, peticioni, iniciativa e qytetarëve, komitetet konsultative, këshillat e vendbanimeve dhe fshatrave, takimet me qytetarë, transparenca dhe diskriminimi pozitiv për komunitetet joshumicë*.

Me LVL komunës i janë dhënë tre lloje të pushteteve: *pushtetin vetanak, pushtetin e deleguar dhe pushtetin e zgjeruar* për disa komuna me shumicë serbe dhe nuk janë të transferueshme tek ndonjë subjekt tjetër. Kompetencat e deleguara hyjnë në grupin e kompetencave shtetërore dhe ato mund të ju mirren komunave kur konstatohet se ato nuk kanë kapacitete për ushtrimin me cilësi të tyre. Po ashtu LVL iu ka dhënë më shumë kompetenca vetanake komunave (18) duke i transferuar kompetencat fakultative (sipas rregulloreve të UNMIK) në kompetenca vetanake<sup>8</sup>. Në të njëjtën mënyrë e kanë të rregulluar edhe shtetet tjera të studiuara, por ato e kanë të caktuar standardin ligjor për krijimin e mundësisë së delegimit të kompetencave nga autoritetet qendrore në ato lokale, pa i përcaktuar cilat, për dallim nga ajo siç është përcaktuar me LVL. Edhe pse komunat nuk kanë kapacitete të njëjta, ato kanë kompetenca të njëjta dhe të pa shkallzuara, me përjashtim të komunave me shumicë serbe. Po ashtu është vërejt problemi i përcaktimit jo të qartë të titullarit dhe i të drejtës së menaxhimit të pronës komunal dhe emërtimi gabim i kompetencës vetanake "*regjistri civil*" në vend të *regjistrimit civil*. Gjithashtu janë identifikuar probleme në bartjen e plotë të kompetencave të deleguara dhe mungesën e mekanizmave ligjor për parandalimin e marrjes së kompetencave nga niveli qendror.

Në përputhje me këtë lloj pushteti dhe në bazë të pritjeve të qytetarëve dhe grupeve të interest, ligji përcakton llojin e organizimit të PL. Ligji përcakton në vija të trasha parimet e përgjithshme të organizimit dhe të funksionimit të organve të VQL, duke iu mundësuar komunave që nëpërmjet akteve komunale: statutit dhe rregullores së punës, të saktësojnë specifikat organizative dhe funksionale të secilës komunë.

LVL saktëson parimet e kornizës ligjore për organizimi dhe funksionimi i PL. Në bazë të kësaj PL mund të organizohet vetëm në një nivel të qeverisjas lokale - niveli komunal. Ligji në përputhje me kushtetutën, dallon vetëm një komunë - Prishtinën si Kryeqytet i vendit, që organizohet dhe funksionon në bazë të një ligji të veçantë. Ligji ende nuk është miratuar dhe Prishtina ende funksionon në bazë të LVL.

Ligji ka përcaktuar qartë adresën e përgjegjësve të funksionimit të sistemit të VQL në dy shtylla kryesore: kuvendin e komunës dhe kryetarin e komunës, në veçanti janë

---

<sup>7</sup> MAPL: "*Ligji për Vetëqeverisjen Lokale*", Prishtinë 2008, Neni 70, 71.

<sup>8</sup> MAPL: "*Analizë, ndryshimet ligjore të sistemit të vetëqeverisjes lokale në Kosovë*", Prishtinë, 2012, fq. 34.

qartësuar përgjegjësitë e kryetarit të komunës. Ligji u jep autonomi të lartë komunave në organizimin dhe funksionimin e administratës lokale duke i heq kufizimet dhe orientimet e përcaktuara me rregulloret e UNMIK – ut. Ligjërisht është përcaktuar se administrata komunale duhet të organizohet në drejtori, për numrin dhe llojin e së cilave mund të vendosin vet komunat, respektivisht kjo është e drejtë e kryetarit të komunës, të cilën të drejtë komunat e përcaktojnë me statutin e tyre si aktin themelor komunal për organizimin dhe funksionimin e komunës. Kjo autonomi ligjore është rregulluar me një vendim të qeverisë në përcaktimin e numrit maksimal dhe minimal të lejuar në administratën lokale (*shih kapitulli 6*).

*Heqja e kryeshefit ekzekutiv si udhëheqës i administratës lokale dhe e drejta e kryetarit për emërimin e drejtorëve edhe me bazë politike, pa caktimin e kritereve profesionale, nuk është në përputhje me parimet e ligjeve organike horizontale për administratën shtetërore dhe shërbimin civil.*

Ligji ka përcaktuar të drejtat e një autonomie të theksuar në menaxhimin e financave lokale të Komunave. Këto të drejta janë zbrëthyer dhe specifikuar me ligjin e vecantë për *Financat e Pushtetit Lokal*. Komunat kanë të drejtë të vendosin, të caktojnë, të mbledhin dhe të shpenzojnë të hyrat e veta si dhe të marrin fonde nga Qeveria.

Korniza ligjore u krijon të drejtën komunave që të hyjnë në bashkëpunim ndër-komunal dhe ndër-kufitar, por pa të drejtë të formimit të një niveli të dytë apo të ndërmjetëm. Komunës iu është mundësuar që të hyjnë në bashkëpunim me komunat tjera në funksion të zhvillimit më të shpejtë ekonomik lokal, të efikasitetit dhe efektivitetit të ofrimit të shërbimeve ndaj qytetarëve dhe grupeve të ndryshme të interesit. E drejta e bashkëpunimit në nivelin lokal, si në aspektin ndër-komunal nacional dhe atë komunal ndërkombëtar, si dhe e drejta për të formuar dhe për t'u anëtarësuar në shoqata, është njëra nga të drejtat dhe parimet e promovuara dhe të garantuara me Kartë (KEVL).<sup>9</sup> Është me rëndësi që një komunë mund ta mandatojë një komunë tjetër për suhtrimin e një kompetence vetanake që nuk ka kapacitete ta ushtrojë vetë. Ndërkaq bashkëpunimi komunal ndërkombëtar është kufizuar vetëm në aspektin administrativ dhe teknik, me përjashtim të komunitetit serb, i cili ka të drejtë të bashkëpunojë me Serbinë në fusha të rëndësishme shtetërore. Praktikant ndërkombëtare flasin për të drejta të pakufizuara të bashkëpunimit ndërkombëtar të komunave për kompetencat që i kanë të përcaktuara me ligj.

Ligji u jep të drejtë komunave në formimin e asociacioneve të komunave për mbrojtjen dhe promovimin e interesave të tyre të përbashkëta. Asociacionet e komunave, sikur edhe në sistemin ligjor ndërkombëtar, nuk kanë të drejtë të ushtrojnë asnjëlloj të pushtetit. Asociacioni i komunave luan rolin e ndërmjetësuesit të interesit të asociacionit

---

<sup>9</sup> Këshilli i Evropës: “Karta Evropiane për Vetëqeverisje Lokale”, Neni 10.

përkatës dhe mund të ofrojë shërbime për anëtarët e asociacionit dhe jo të ndonjë subjekti tjetër publik apo privat. Asociacioni krijon mjedisin dhe ndërton kapacitetet e saj për t'iu ndihmuar komunave që t'i ushtrojnë kompetencat e tyre në mënyrë profesionale.

Ligji në të njëjtën kohë i ka dhënë komunës shkallë të lartë të autonomisë por edhe i ka krijuar mekanizma të dyfishtë të mbikëqyrjes së funksionimit të tyre. Puna e organeve komunale mbikëqyret nga MAPL dhe ministritë sektoriale në njërën anë dhe në anën tjetër nga vetë qytetarët nëpërmjet iniciativës së qytetarëve, sipas mekanizmave të caktuar ligjor. Bashkëpunimi ndërmjet autoriteteve qendrore dhe atyre lokale, ligjërisht janë ndërtuar mbi tri parime themelore, si:

- Respektimi i plotë i Kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë;
- Forcimi dhe aftësimi i organeve të komunave në zbatimin e përgjegjësive; dhe
- Sigurimi i respektimit të të drejtave dhe lirive qytetare.<sup>10</sup>

Po ashtu janë ndërtuar mekanizmat jo shumë të qëndrueshëm në funksion të parandalimit të shkeljes së ligjit gjatë punës së tyre (shqyrtimi paraprak) dhe poashtu, nëse kjo nuk ndodhë, është mundësuar që puna e organeve komunale të shqyrtohet pas marrjes së vendimeve dhe para zbatimit të tyre nga organi mbikëqyrës - MAPL. Rishikimi administrativ kufizohet në sigurimin e përputhjes së aktiviteteve komunale me kushtetutën dhe me ligjin. Kjo i siguron autonomi të lartë komunës. *(shih kapitullin 7)*

## **Ligjet e Veçanta dhe Aktet Nënligjore**

Derisa me ligjet organike është rregulluar në parim ndërtimi dhe funksioni i sistemit të VQL, me ligjet specifike është rregulluar ndërtimi dhe funksioni i fushave të caktuara të cilat me ligj nuk janë rregulluar në mënyrë specifike. Me ligje specifike janë rregulluar disa fusha specifike të SVQL, si: zgjedhjet lokale, krijimi i komunave dhe kufijtë administrativ të tyre, menaxhimi financave lokale, bashkëpunimi ndërkomunal dhe ndërkufitar, shfrytëzimi i tokës dhe menaxhimi i kompanive publike rajonale. Ndërkaq ndërtimi dhe funksionimi i SVQL është rregulluar me ligje tjera organike dhe të veçanta ndërsektoriale të ministrive të linjës. Në bazë të analizave të bëra rezulton se fushat kryesore të funksionimit të VQL janë të rregulluara me ligje dhe akte tjera nënligjore. Nga hulumtimet e bëra është konstatuar se secila kompetencë e komunave, së paku është e rregulluar nga një ligj e më shumë. *Shih shtojca 2.*

---

<sup>10</sup> Kuvendi i Kosovës: “*Ligji për Vetëqeverisje Lokale*”, Kreu X, Neni 74.



Shumë fusha të funksionimit të sistemit të VQL janë rregulluar me udhëzime administrative, të miratuara nga MAPL dhe ministrinë e linjës. *Shih shtojcën 3.* Gjithashtu MAPL dhe ministrinë tjera të linjës kanë hartuar doracak të ndryshëm për dhënien e udhëzimeve profesionale në fusha të ndryshme, si: Monitorim të funksionimit të kuvendeve komunale, hartimin e akteve komunale, ndërtimin e kapaciteteve në komuna, matjen dhe vlerësimin e performancës së komunave etj., por mungon një doracak i përgjithshëm për dhënien e udhëzimeve profesionale për ndërtimin dhe funksionimin e sistemit të VQL.

### Aktet komunale

Me LVL është përcaktuar se me cilat akte komunale komunat e rregullojnë fushëveprimtarinë e vetë. Në përputhje me këtë komunat kanë nxjerrë statute, rregullore dhe vendime për ushtrimin e kompetencave të tyre në fushat e përcaktuara me kornizën ligjore. Komunat i miratojnë dhe i nxjerrin aktet e tyre komunale, kryesisht në përputhje me kornizën ligjore, por është konstatuar se një numër i tyre nuk janë miratuar dhe nuk zbatohen në përputhje të plotë me kornizën ligjore.

Korniza ligjore është e ballafaquar me problemin e ndryshimeve të shpeshta të ligjeve dhe akteve tjera juridike përkatëse, që jo gjithëherë arrihet harmonizimi i tyre me infrastrukturën ekzistuese ligjore. Po ashtu rregullimi i fushave të caktuara në PL, nuk përcillet me burimet dhe kapacitetet e nevojshme për zbatimin e tyre. Ligjet dhe aktet tjera janë më të përparuara se ndërtimi i kapaciteteve profesionale në komuna. Korniza ligjore është shumë e hapur që do të thotë se institucionet dhe zyrtarët e tyre kanë një shkallë të lartë të autonomisë në punën e tyre. Kjo shkallë e lartë e autonomisë ka lënë të shkruar një pjesë të ligjit në përgjegjësinë profesionale dhe morale të bartësve të institucioneve dhe zyrtarëve të tyre, që duket të jetë e parakohshme për nivelin e kërkuar të përgjegjësisë së tyre. Si pasojë e kësaj sistemi nuk prodhon efekte përfundimtare të plota. Problemet më të mëdha janë zbrastësirat ligjore, duke krijuar pasiguri juridike, dhe mungesa e mekanizmave për detyrim të zbatimit të ligjeve.

Problem në veti paraqitet shkalla e ulët e informimit të opinionit publik për të drejtat e tyre dhe procedurat e ofrimit të shërbimeve nga ana e autoriteteve lokale. Komuna nuk ka mekanizma për ofrimin e shërbimeve juridike për qytetarët. Ata në mungesë të njohurive, shpesh herë nuk i pranojnë shërbimet e garantuara me ligj.

# SISTEMI I VETËQEVERISJES LOKALE DHE DECENTRALIZIMI

## Parimet e Demokracisë Lokale

Në shoqëritë demokratike, funksionimi i sistemeve qeverisëse, e në veçanti ai demokracisë lokale, mbështetet në parime të forta të interesit dhe vlerave të komunitetit lokal dhe të interesave të përgjithshme të nivelit kombëtar dhe ndërkombëtar. Varësisht nga shkalla dhe rrethanat e zhvillimeve shoqërore e politike, vendet e ndryshme, përcaktojnë parime të ndryshme për qeverisjen e tyre në nivel lokal, por në përgjithësi zotërojnë disa parime themelore apo vitale nëpërmjet të cilave përcaktohet karakteri i qeverisjes, ashtu siç është konstatuar edhe në dokumentin vlerësues të kompetencave të katër vendeve anëtare të BE (Madrid 2005), sipas të cilit, qeveritë vendore duhet të udhëhiqen në bazë të këtyre parimeve kryesore: vetëqeverisja, proporcionaliteti, subsidiariteti, diversiteti dhe fleksibiliteti.

Në Republikën e Kosovës, qeverisja lokale është e bazuar në parimet e qeverisjes së mirë, transparencës, subsidiaritetit, ofrimit të shërbimeve në mënyrë efikase dhe efektive, duke u kushtuar kujdes të veçantë nevojave dhe brengave specifike të komuniteteve që nuk janë shumicë dhe pjesëtarëve të tyre<sup>11</sup>. Parimi i autonomisë lokale tani po zëvendësohet me parimin e vetëqeverisjes lokale, nga se autonomia po identifikohet si rrugë e federalizmit të njëjësive lokale dhe largimi nga interesi i drejtpërdrejt i qytetarit. *Qeverisja lokale në Kosovë përpriqet që t'i zbatojë në praktikë të gjitha këto parime të vendeve të BE por duke ia përshtat rrethanave aktuale.*

## Decentralizimi dhe Reforma e Pushtetit Lokal

Aktualisht trendët e zhvillimit të qeverisjes në botë, janë duke u zhvilluar në dy kahe të ndryshme. Në njërën anë, në kuptimin e jashtëm, është duke shkuar drejt globalizimit dhe në anën tjetër, në kuptimin e brendshëm, është duke shkuar drejt lokalizimit apo fuqizimit të vetëqeverisjes lokale - Decentralizimit. Në këtë kuptim, të gjitha vendet e botës kanë të ndërtuara sisteme të qeverisjes lokale në përputhje me zhvillimet politike, ekonomike dhe nevojat e qytetarëve. Ngritja e të menduarit publik dhe presioni i lartë i komuniteteve lokale për pjesëmarrje më të madhe në procesin e vendimmarrjes, ka shkaktuar vendosjen e autoriteteve lokale ballë për ballë me kërkesa të reja<sup>12</sup>. Përmbyshja e kërkesave të komunitetit lokal po e sjellë nevojën e decentralizimit të qeverisjes nga pushteti qendror në autoritetet lokale.

---

<sup>11</sup> Kuvendi i Kosovës: “Kushtetuta e Republikës së Kosovës”, neni 123, pika 4 dhe LVQL, neni 15.

<sup>12</sup> Robin Hambleton: “Modernising Political Management in Local Governments”, 37 URBAN STUDIES 931, 931 (2000).

Autoritetet lokale gjithnjë e më shumë po fitojnë liri të veprimit nga niveli qendror dhe në përgjithësi kanë pushtet që krijojnë burime nga të hyrat vetanake dhe që gjithashtu pranojnë ndihmë nga qeveria. Në përgjithësi po përvijohen tri koncepte themelore të decentralizimit dhe të organizimit të PL.

- **Koncepti i parë** ka të bëjë me llojin e decentralizimit të orientuar në përfshirjen e komuniteteve në qeverisje, që ndryshe quhet si decentralizim politik;
- **Koncepti i dytë** ka të bëjë me llojin e decentralizimit të orientuar në ofrimin e shërbimeve cilësore për qytetarët, që ndryshe quhet si decentralizim administrativ dhe
- **Koncepti i tretë** është përzierje e dy koncepteve, që është i orientuar në përfshirjen e komuniteteve dhe ofrimin e shërbimeve cilësore. Në Kosovë është tentuar të zbatohet ky lloji i decentralizimit.

Shpesh herë ka ndodhë që “Decentralizimi” si proces dhe koncept mund të mos jetë kuptuar drejt por edhe është keqinterpretuar apo keqkuptuar si qëllim përfundimtar. Ofrimi i mundësive që vetë qytetarët të marrin në dorë fatin e zhvillimit dhe të rritjes së mirëqenies së tyre, në vendin ku jetojnë, është në përputhje të plotë me parimet më të larta të një qeverisje demokratike apo të një qeverisje me qytetarin në qendër. Decentralizimi në Kosovë është bërë në kontekstin e zhvillimit dhe avancimit qeverisjes lokale duke synuar plotësimin e nevojave të qytetarëve dhe ofrimin e shërbimeve më afër tyre dhe sa më cilësore (interesi nën - nacional), si dhe në kontekstin e detyrimeve politike për të cilat Kosova i ka pranuar dhe është zotuar me Marrëveshjen Gjithëpërfshirëse të Pakos së Ahtisarit për Shpalljen e Pavarësisë së Kosovës, e cila është pranuar, miratuar dhe inkorporuar në aktet më të lartë politik-juridike.

Reforma e pushtetit lokal ka të bëjë me ndërtimin e një sistemi qeverisës që u mundëson qytetarëve, në radhë të parë, të komunikojnë ndërmjet veti, t’i shprehin interesat e tyre të përbashkëta dhe të përfaqësojnë frymën e komunitetit të cilit i takojnë. Riorganizimi i një sistemi i cili përçon këto interesa, shpirtin e komunitetit dhe vlerat e tij, ka qenë synimi i MAPL dhe i Qeverisë së Kosovës. Reformë nuk do të thotë kalimi prej një sistemi në tjetrin, por ndërtim, zhvillim dhe përshtatje të mekanizmave ligjor, administrativ dhe ekonomik të pushtetit lokal për të përfaqësuar në mënyrë të drejtë interesat dhe vlerat e komunitetit.

Kalimi prej një sistemi të centralizuar socialist, në një sistem demokratik, krahas ndryshimeve tjera sistemore është bërë edhe decentralizimi i një pjese të pushtetit qendror tek ai lokal dhe kjo bartje nuk është vetë reforma, por është një segment i rëndësishëm i një sistemi të reformuar. Decentralizimi bën të mundur zbatimin e një sistemi demokratik që buron nga vota e qytetarit dhe punon afër qytetarit për të plotësuar nevojat e përditshme që burojnë nga secili qytetar i komunitetit përkatës. Sistemi i vetëqeverisjes lokale (SVQL) ka krijuar mekanizma ligjor dhe administrativ për të siguruar se pushteti i zgjedhur nga qytetarët me votën e lirë është në funksion të tyre.

Decentralizimi politik në Kosovë rrjedhë nëpërmjet një mjedisi të ndërlikuar politik, në të cilin shfaqen përkrahësit dhe kundërshtuesit e tij. Ky lloj decentralizimi në fillim ishte i orientuar kryesisht në integrimin e komuniteteve jo shumicë, me theks të veçantë të komunitetit serb, i cili për shkaqe politike bojkotonte çfarëdo forme të bashkëpunimit me institucionet e Kosovës, pavarësisht se shfrytëzonte pasuritë dhe buxhetin e saj. Partitë politike serbe, duke vlerësuar se procesi i decentralizimit është dhe po zhvillohet në interes të përgjithshëm të qytetarëve me theks të veçantë të komunitetit të tyre, vendosën që të përkrahin dhe marrin pjesë në proces duke bashkëpunuar me institucionet e Kosovës, për krijimin e komunave të reja. Zhvillimi i rrethanave dhe opinionit politik në vend kundër këtij procesi, në atë kohë, bëri që MAPL-ja, si institucioni bartës i këtij procesi të mbështetje dhe përkrahje të mjaftueshme. Megjithatë, falë përkushtimit, punës së vazhdueshme, përkrahjes së Zyrës Civile Ndërkombëtare (ZCN) dhe faktorit ndërkombëtar, procesi u zhvillua sipas prioriteteve të përcaktuara, ku u themeluan 7 komuna të reja, ndërsa komuna e Mitrovicës së Veriut është në proces.

Në një anketë e zhvilluar me komunitetin serb në Graçanicë, Partesh dhe Novobërdë, del se 78.8% e tyre e përkrahin decentralizimin<sup>13</sup>.

Me kalimin e kohës u kuptua se përkrahja e procesit të decentralizimit nuk ishte përkrahje e të ashtuquajturave “politikave selektive”, por e gjithë qytetarëve të Kosovës. Takimet politike përfunduan me bashkëpunim të ndërsjellë me përfaqësuesit politik të komunitetit serb dhe zbatimin e procesit në të gjitha dimensionet e tij. Me procesin e decentralizimit komuniteti serb u integrua plotësisht në jetën institucionale ekonomike dhe shoqërore të vendit me përjashtim të pjesës veriore të Kosovës. Qytetarëve të Kosovës iu ofrua mundësia e zgjedhjes së përfaqësuesve të tyre në kuvend dhe në ekzekutivin e komunës. Po ashtu u decentralizuan edhe shërbimet administrative dhe qytetarët kanë mundësi të marrin shërbime më cilësore dhe më të shpejta me qendër në komunitet.

---

<sup>13</sup> Qendra për Zhvillim Social: “Anketë me qytetarë serb në Graçanicë, Novobërd dhe Partesh, Graçanicë”, 2008.

**Tabela 2: Pasqyrimi i të hyrave vetanake në komunat e reja<sup>14</sup>.**

| Komuna        |      | Grantet   | I të hyrat<br>vetanake | Ministritë e<br>linjës | Donacionet | Gjithsej investimet<br>kapitale |
|---------------|------|-----------|------------------------|------------------------|------------|---------------------------------|
| Graçanicë     | 2010 | 3,506,329 | -                      | -                      | -          | 3,506,329                       |
|               | 2011 | 1,175,978 | 725,119                | 1,217,626              | 443,542    | 3,562,267                       |
| Hani i Elezit | 2009 | 205,883   | 169,333                | 134,000                | 247,000    | 756,216                         |
|               | 2010 | 196,826   | 211,267                | 136,000                | 269,200    | 813,293                         |
| Junik         | 2011 | 261,860   | 252,182                | 206,731                | 505,801    | 1,226,871                       |
|               | 2009 | 171,565   | 63,769                 | 300,000                | 20,000     | 555,334                         |
|               | 2010 | 552,946   | 74,406                 | 77,000                 | 67,000     | 876,431                         |
| KilokotVërboc | 2011 | 112,057   | 73,860                 | -                      | 37,556     | 653,172                         |
|               | 2010 | 110,509   | -                      | 226,383                | 97,960     | 434,852                         |
| Mamushë       | 2011 | 1,147,578 | -                      | -                      | 77,245     | 1,324,873                       |
|               | 2009 | 133,315   | 109,15                 | 350,000                | 35,000     | 559,260                         |
|               | 2010 | 129,128   | -                      | 96,000                 | 75,000     | 300,128                         |
| Novobërdë     | 2011 | 236,812   | -                      | -                      | 5,820      | 242,632                         |
|               | 2009 | 307,996   | 2,995                  | 935,500                | 932,543    | 2,179,034                       |
|               | 2010 | 885,505   | 28,532                 | 304,361                | -          | 1,218,398                       |
| Partesh       | 2011 | 1,205,195 | 52,609                 | 203,298                | 7,200      | 1,468,301                       |
|               | 2010 | 631,492   | -                      | -                      | -          | 631,492                         |
| Ranilug       | 2011 | 673,011   | -                      | 300,000                | -          | 973,011                         |
|               | 2010 | 691,515   | -                      | -                      | 8,281      | 712,799                         |
| Shërpelë      | 2011 | 406,787   | -                      | -                      | 26,728     | 433,515                         |
|               | 2009 | 595,122   | 5,405                  | -                      | -          | 590,606                         |
|               | 2010 | 2,515,970 | 12,238                 | 97,910                 | 781,108    | 3,408,256                       |
|               | 2011 | 2,060,874 | 68,068                 | 779,304                | 46,033     | 2,954,278                       |

Megjithëse, përfaqësimi i komunitetit serb në nivelin qendrorë ishte 20%, decentralizimi shndërrohet në një mjet për zgjedhjen dhe avancimin e stabilitetit politik në vend. Për më tepër Qeveria duhet të ndajë disa kompetenca shtesë në mënyrë që të sigurojë se pala serbe do të fitonte një vetëqeverisje të cilësuar për të plotësuar nevojat politike lokale të komunitetit. Edhe pse qeveria e Kosovës bëri shumë kompromise në favor të komunitetit serb, pala serbe prapë nuk ishte e kënaqur. Kosova me decentralizimin po demonstronte gatishmërinë e ndërtimit të shtetit, sigurimin e stabilitetit dhe shtrirjes së sovranitetit të tij edhe nëse do të ballafaqohej me sfida të mëdha. Procesi i decentralizimit po u ofronte mundësi më të mira të gjitha komuniteteve, në veçanti komunitetit serb, i cili nuk po jetonte mirë me një sistem paralel të përkrahur nga Beogradi.

<sup>14</sup>USAID: “Sukseset dhe Sfidat e Komunave të Reja”, USAID, Prishtinë, 2012, fq. 59.

Zgjidhjet politike, gjithëherë kërkojnë mjete politike. Decentralizimi nga niveli qendror në atë lokal, i bazuar në dy shtylla kryesore: ofrimin e shërbimeve sa më afër qytetarit dhe përfshirjen e komuniteteve në procesin e vendimmarrjes, edhe atëherë kur nuk ka arsyeshmëri ekonomike, e bën sistemin e vetëqeverisjes lokale shumë fleksibil dhe të shtrenjtë.

Sistemi i vetëqeverisjes lokale është i ndërtuar edhe në bazë të parimeve të përgjithshme ndërkombëtare dhe është duke u sprovuar në misionin e tij. Në bazë të analizave të bëra deri tani, sistemi i vetëqeverisjes lokale është i ndërtuar në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe me nevojat e qytetarëve të Kosovës, por kërkohet që të bëhen përmirësime dhe përshtatje të disa aspekteve të funksionimit të tij, që praktikisht janë vërtetuar se nuk funksionojnë mirë. Përmirësimet dhe përshtatjet janë pjesë përbërëse e sistemeve që kanë për qëllim zhvillimin e lokalitetit ku veprojnë dhe jo vetëm sistemit. Përmirësimi i funksionimit të sistemit asnjëherë nuk përfundon sikur që nuk përfundon asnjëherë kërkesa për një jetë më të mirëqenë të qytetarëve.

## **Kompetencat e Pushtetit Lokal**

Me procesin e decentralizimit janë përcaktuar më shumë kompetenca vetanake të komunës, si njësi bazë e qeverisjes lokale, si dhe janë bartë shumë kompetenca tjera të pushtetit qendror. Kompetencat vetanake<sup>15</sup> (themelore) janë pjesë përbërëse e vetë SVQL, për të cilat të drejta edhe është themeluar sistemi. Në kushtet e zhvillimeve të ndryshme politike, shoqërore e ekonomike, kompetencat themelore nuk mjaftojnë për të përmbushur kërkesat e qytetarëve të komunitetit dhe në këtë kuptim, qeveria e Kosovës i ka bartë PL disa kompetenca shtesë (të zgjeruara)<sup>16</sup> dhe disa të tjera ia ka deleguar<sup>17</sup>.

Qeveria i ka ndarë komunitetit serb disa kompetenca nga pushteti qendror (PQ) për të rritë kapacitetin e qeverisje për disa fusha specifike të kërkuara nga komuniteti serb. Kompetencat e zgjeruara për komunitetin serb ndikuan në krijimin e kushteve për integrimin e tyre në institucionet e vendit dhe krijimin e një mjedisi të qëndrueshëm politik dhe hapjen e perspektivës për një jetë të përbashkët.

---


<sup>15</sup> Kuvendi i Kosovës: “*Ligji për Vetëqeverisjen Lokale*”, neni, 17.

<sup>16</sup> Kuvendi i Kosovës: “*Ligji për Vetëqeverisjen Lokale*”, neni, 19.

<sup>17</sup> Kuvendi i Kosovës: “*Ligji për Vetëqeverisjen Lokale*”, neni, 18.

## Sistemi i Vetëqeverisjes Lokale

Bartja dhe funksionimi i një pjese të madhe të pushtetit pranë dhe në shërbim të nevojave të qytetarëve nuk është një proces i thjeshtë. Ky proces përshinë shumë akterë, shumë struktura organizative dhe shumë procese. Të gjitha këto segmente (hallka) duhet të organizohen në atë mënyrë që të punojnë dhe funksionojnë bashkë për një qëllim. Se a do të të arrihet qëllimi politik i vetëqeverisjes lokale varet shumë nga ndërtimi, organizimi dhe funksionimi i sistemit. Nëse një sistem nuk arrin me iu shërbyer qytetarëve në mënyrë efikase dhe efektive, atëherë duhet shikuar dhe rishikuar se çfarë nuk funksionon në kuadër të sistemit. Sistemi i vetëqeverisje në Kosovë është i ndërtuar dhe funksionon në bazë të një kornize ligjore, që përcakton rregullat e ndërtimit dhe funksionimit. Mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të sistemit të VQL e përcaktojnë nevojat e qytetarëve dhe grupeve të ndryshme të interesit, për të cilët edhe ekziston sistemi.



*Fig. 1. Organizimi i marrëdhënies së komunës me grupet e ndryshme të interesit*

*Grupet e interesuara* janë të gjithë ata qytetarë apo grupe të ndryshme të qytetarëve të cilët kanë interesa të caktuar nga komuna dhe që kërkojnë plotësimin e tyre nga ajo. Dallojmë grupet e brendshme të interesit (të punësuarit e niveleve të ndryshe në komunë) dhe grupet e jashtme të interesit: shih figurën 1. MAPL nëpërmjet kornizës ligjore i ka përligjur nevojat e grupeve të interesit nëpërmjet përcaktimit të llojeve të shërbimeve që sistemi i VQL do t'iu ofron.

SVQL është i ndërtuar prej një niveli të pushtetit, i cili ruan lidhjen e funksionimit me PQ dhe me strukturat e dekoncentruara të tij në më shumë se një komunë. Sistemi i VQL në Kosovë është jo shumë i ndërlidhur, strukturat e të cilit kanë funksione kryesisht të qarta, por edhe autonome. Me qëllim të përfaqësimit të vullnetit të qytetarëve në qeverisje, është themeluar kuvendi i komunës dhe kryetari i komunës, ndërsa shumë drejtorate u ofrojnë shërbime të ndryshme administrative, profesionale dhe teknike qytetarëve dhe grupeve të ndryshme të interesit. Sistemi i VQL, vjelë të hyra nga veprimtaritë e ndryshme të grupeve të interesit, tatimet individuale të qytetarëve dhe merr grante nga PQ, i planifikon ato dhe i orienton në bazë të prioritetëve në zhvillimin e komunës dhe rritjen e mirëqenies së qytetarëve.

**Tab. 1.** Sistemi i vetëqeverisjes lokale dhe ndërlidhjet me PQ

| <b>Kuvendi i Kosovës</b> | <b>Qeveria e Kosovës</b>   | <b>Agjencitë shtetërore</b>                                   | <b>Ndërmarrjet publike</b>       |
|--------------------------|--|---|----------------------------------|
|                          | Dekoncentrimi i strukturave të PQ                                      | <b>Autoritetet e pavarura</b>                                 |                                  |
|                          | Zyrat<br>Agjencionet<br>Qendrat  |   | Ndërmarrjet publike rajonale     |
| <b>Kuvendi i komunës</b> | Kryetari i komunës<br>Administrata<br>Drejtoratet<br>Sektorët<br>Zyrat | Kompetencat:<br>Vetëqeverisje<br>Të deleguara<br>Të zgjeruara | Ndërmarrjet publike komunale     |
| <b>Votuesit</b>          | Qytetarët dhe grupet e interesit                                       | Qytetarët (qytetarët serb) dhe grupet e interesit             | Qytetarët dhe grupet e interesit |

**Karakteristikat themelore të sistemit.** Autonomia e theksuar e VQL, që shprehet nëpërmjet tri lloje të kompetencave të komunave, por me sistem fiskal të centralizuar. Struktura e përzier organizative e administratës, ku përfaqësuesit politik janë edhe pjesë e administratës civile. Ky sistem i orientuar kryesisht në përfaqësim politik të komuniteteve dhe mjaft autonom në brendinë e tij i mungojnë mekanizmat për garantimin e suksesit të plotë. Zbatimi i kritereve të dyfishta politike në delegimin e kompetencave për vetëm një komunitet politik dhe zbatimi i kritereve të njëjta profesionale për të gjitha komunat. Mekanizmat mbikëqyrës e rrisin shkallën e autonomisë dhe të përfaqësimit politik dhe në të njëjtën kohë e bëjnë sistemin më të ngadalshëm në efikasitetin dhe efektivitetin e tij.



## **ORGANIZIMI I PUSHTETIT LOKAL**

Organizimi i pushtetit lokal (PL) në Kosovë ndërlidhet me konceptin e tretë të VQL (shih më lartë mbi konceptet e VQL) apo të përfshirjes së komuniteteve dhe të ofrimit të shërbimeve cilësore. Organizimi një nivelesh i PL ka qenë edhe para vitit 1999, sipas sistemit socialist. Pas vitit 1999, si rezultat i vendosjes së Kosovës nën Protektorat Ndërkombëtar, vendosen bazat e organizimit demokratik të PL, në frymën e Kartës Evropiane për Vetëqeverisje Lokale. Fillimisht ky proces u rregullua me Rregulloren e UNMIK Nr. 2000/45, pastaj me Rregulloren e UNMIK Nr. 2007/30 dhe aktualisht organizimi i Vetëqeverisjes Lokale rregullohet me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale dhe Ligjin për Kufijtë Administrativ të Komunave, Ligjin për Bashkëpunim Ndër - komunal dhe Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal.

I gjithë procesi i riorganizimit të PL në Kosovë është quajtur, reformë e pushtetit lokal. Reforma e pushtetit lokal ka synuar që, nëpërmjet decentralizimit, t'i përfshijë qytetarët, bizneset dhe komunitetet në procesin e vendimmarrjes dhe krijimin e mekanizmave të brendshëm për zbatimin e politikave dhe vendimeve në shërbim të tyre. Për integrimin më të shpejtë të komuniteteve në sistemin e vetëqeverisjes lokale është ndërtuar një lloj organizimi asimetrik, ku komunitetit serb i lejohen kompetenca shtesë për dallim prej grupeve tjera etnike. Megjithatë organizimi i PL me qytetarin në qendër dhe në shërbim të qytetarit ka qenë qëllimi kryesor i reformës.

Qeverisja e vendit është e organizuar në dy nivele: niveli i pushtetit qendror (NQ) dhe niveli i pushtetit lokal (PL). Qeverisja qendrore zhvillon dhe zbaton politikat shtetërore për zhvillimin dhe ruajtjen e vendit, ndërsa vetëqeverisja lokale zbaton politikat e nivelit qendror dhe ato vendore në shërbim të qytetarëve të saj. Organizimi i PL përfshinë: organizimin territorial të komunave, organizimin e PL në komunë dhe bashkëpunimin ndërkomunal, rajonal dhe ndërkufitar.

### **Organizimi Territorial i Komunave**

Republika e Kosovës shtrihet në një sipërfaqe prej 10908 km<sup>2</sup>, e cila është e ndarë në 38 njësi administrative apo në 38 komuna, të cilat shtrihen dhe veprojnë në kushte specifike territoriale. Komunat, fillimisht janë të themeluara me Rregulloren e UNMIK-ut 2000/43, në vitin 2000, derisa Kosova ishte nën administrimin e UNMIK. Sot, organizimi territorial dhe përcaktimi i kufijve administrativ të komunave është rregulluar me Ligjin për Kufijtë Administrativ të Komunave.

Nga viti 2008 deri në vitin 2012, janë themeluar 7 komuna të reja dhe një komunë, ajo e Mitrovicës së Veriut, është në proces të themelimit. Dy komunat e Mitrovicës, për dallim nga komunat tjera, do ta themelojnë një Bord të Përbashkët Funkcional, i përbërë prej 11 anëtarëve, 1 ndërkombëtar, që është edhe udhëheqës i bordit dhe nga 5 anëtar nga secila komunë.

Organizimi territorial i komunave është i ndryshueshëm. Ligjet në fuqi krijojnë mundësinë e lëvizjes së kufijve ndërmjet komunave dhe shkëputjen apo bashkimin e pjesëve territoriale të tyre. Në këtë mënyrë, nga shkëputja e territorit të komunave ekzistuese dhe bashkimi i tyre, janë formuar komunat e reja në Republikën e Kosovës, si: Graçanica, Parteshi, Ranillugu, Klllokoti, Hani i Elezit, Mamusha dhe Juniku. Krijimi i komunave të reja është bërë në llogari të territorit të komunave: Prishtinë, Lipjan, Fushë Kosovë, Kamenicë, Novobërdë, Gjilan, Viti, Kaçanik, Prizren, Suharekë, Rahovec, Suharekë, Deçan dhe Gjakovë. Komunat e reja kanë marrë 265.4 km<sup>2</sup> territor të komunave ekzistuese apo 2% e territorit të Kosovës.

Kriteret themelore për themelimin e komunave të reja apo riorganizimin e komunave ekzistuese janë: konsultimi i qytetarëve, qasja më e lehtë e qytetarëve në shërbime, qëndrueshmëria ekonomike, parimi i subsidiaritetit dhe ushtrimi i kompetencave. Kriteri i veçantë, është konsultimi i më së paku 75% të komunitetit jo shumicë, kur ky komunitet është i përqendruar në një popullsi prej së paku 5000 banorëve. E drejta për referendum, e përcaktuar me Nenin 5 të Kartës Evropiane për Vetëqeverisje Lokale, nuk është sanksionuar si kriter në vendin tonë. Konsultimi nuk është formë e praktikueshme e vendimmarrjes për çështje madhore si ndryshimi i kufijve të komunave dhe formimi i komunave të reja. Po ashtu, parimi i efektshmërisë së entitetit të ri (komunës), sipas KEVL, është zëvendësuar me kriterin e ushtrimit më të mirë të kompetencave. Ndërkaq, parimi i qëndrueshmërisë ekonomike është përfillë pjesërisht, me rastin e themelimit të komunave të reja.

### Territori i komunave

Madhësia e sipërfaqes së komunave sillet prej 633 km<sup>2</sup> (Podujevë), më e madhja e deri 23 km<sup>2</sup> (Klllokoti), më e vogla. *Madhësia mesatare është 282.7 km<sup>2</sup>*. Komuna më e madhe përfshinë 6% të territorit të Kosovës, ndërsa komuna më e vogël përfshinë 0.23% të territorit. Kështu 57% e komunave kanë territor më të madh se mesatarja e vendit apo mbi 282.7 km<sup>2</sup>, ndërsa 43% e komunave kanë territor më të vogël se mesatarja e vendit. Tetë komuna kanë më pak se 1% të territorit të Kosovës. Kjo do të thotë se në Kosovë dominojnë komunat e mëdha.

Ekzistojnë 34 vendbanime (fshatra) që kanë më shumë se 3300 banor, prej tyre 8 vendbanime me mbi 5000 banorë. Në 13 komuna ka prej 1 – 3 vendbanime me mbi 3300

banor, ndërsa Ferizaj dhe Prizreni kanë 5 – 6 vendbanime me 3410 – 9398 banorë<sup>18</sup>. Në këto dy komuna ka filluar procesi i dekoncentrimit të urbanizimit. Katër komuna kanë numër minimal të vendbanimeve: Komuna e Mamushes ka vetëm 1 vendbanim, Juniku ka 2 vendbanime, Parteshi ka 3 vendbanime dhe Kllokoti ka 4 vendbanime. Pasuria natyrore, sikur edhe numri i banorëve, nuk është e shpërndarë njësoj në tërë territorin e Kosovës, andaj disa komuna posedojnë potencial natyror ekonomik më të madh se disa të tjera.

### Popullsia

Kriteri kryesor për themelimin e komunave është numri i banorëve. Duke u bazuar në numrin e banorëve, komunat mund grupohen në katër (4) grupe kryesore: grupi i parë, komunat me mbi 60.000 banor; grupi i dytë, komunat me mbi 30.000 banor; grupi i tretë, komunat me mbi 5000 banor dhe grupi i katërt komunat me më pak se 5000 banor.

| Grupi i parë mbi 60.000 banorëve |               |                    | Grupi i dytë mbi 30.000 banorë |              |                    |
|----------------------------------|---------------|--------------------|--------------------------------|--------------|--------------------|
| Nr.                              | Komuna        | Numri i popullsisë | Nr.                            | Komuna       | Numri i popullsisë |
| 1                                | Prishtina     | 198897             | 10                             | Suharekë     | 59722              |
| 2                                | Prizren       | 177781             | 11                             | Glllogoc     | 58531              |
| 3                                | Ferizaj       | 108610             | 12                             | Lipjan       | 57605              |
| 4                                | Pejë          | 96450              | 13                             | Rahovec      | 56208              |
| 5                                | Gjakovë       | 94556              | 14                             | Malishevë    | 54613              |
| 6                                | Gjilan        | 90178              | 15                             | Skenderaj    | 50858              |
| 7                                | Podujevë      | 88499              | 16                             | Viti         | 46987              |
| 8                                | Mitrovicë     | 71909              | 17                             | Deçan        | 40019              |
| 9                                | Vushtrri      | 69870              | 18                             | Istog        | 39289              |
|                                  |               |                    | 19                             | Klinë        | 38496              |
|                                  |               |                    | 20                             | Kamenicë     | 36085              |
|                                  |               |                    | 21                             | Fushë Kosovë | 34827              |
|                                  |               |                    | 22                             | Dragash      | 33997              |
|                                  |               |                    | 23                             | Kaçanik      | 33409              |
| Grupi i tretë + 5000 banorë      |               |                    | Grupi i katërt - 5000 banor    |              |                    |
| 24                               | Shtime        | 27324              | 32                             | Ranillug     | 3866               |
| 25                               | Obiliq        | 21549              | 33                             | Kllokoti     | 2556               |
| 26                               | Graçanicë     | 10675              | 34                             | Partesh      | 1787               |
| 27                               | Hani i Elezit | 9403               |                                |              |                    |
| 28                               | Shtërpcë      | 6949               |                                |              |                    |
| 29                               | Novobërdë     | 6729               |                                |              |                    |
| 30                               | Junik         | 6084               |                                |              |                    |
| 31                               | Mamush        | 5507               |                                |              |                    |

**Tab. 2.** Numri i banorëve në komuna sipas regjistrimit të vitit 2011

<sup>18</sup> ASK: “Popullsia sipas Gjinisë, Etnicitetit dhe Vendbanimit”, Prishtinë, 2011.

Kjo tabelë tregon se 26% (1/4) e popullsisë jeton në 9 komuna të mëdha, që vetëm 3 komuna kanë mbi 100.000 banor, ndërsa numri më i madhi tyre apo prej 44% jeton në 15 komuna të mesme dhe 30% e popullsisë jeton në 10 komuna të vogla (nën 30.000 banor, 3 prej tyre nën 5000). Nga regjistrimi i fundit i popullsisë, vërehet ulje e numrit të popullsisë në komuna, që më së shumti është e shprehur në Prishtinë dhe në komunat e reja<sup>19</sup>. Derisa për nga territori dominonin komunat e mëdha, për nga numri i popullsisë, dominojnë komunat e mesme në Kosovë.

### Pasuria natyrore

Komunat janë të shtrira në brezin e gjerësisë së mesme gjeografike, me lartësi mbidetare prej 265m (Vërmica) deri në 2656m (Maja e Gjiravicës në Bjeshkët e Nemura). Në këtë sipërfaqe është e shtrirë një pasuri e madhe mbitokësore dhe po ashtu një pasuri e çmuar nëntokësore, që nuk janë të shpërndara në mënyrë të barabartë sipas kufijve të komunave. Disa komuna kanë potenciale ekonomike natyrore më të mëdha dhe disa tjera kanë më pak.

**Pasuritë kryesore mbitokësore janë:** ajri, uji, toka dhe pyjet, të cilat e krijojnë mjedisin elementar për qytetarët e komunave. *Cilësia e ajrit dhe e ujit* për qytetarët e komunave të ndryshme është e ndryshme. Banorët e komunave të cilat shtrihen afër Basenit të Lignitit, në Rrafshin e Kosovës, janë të ekspozuar ndotjes së madhe të ajrit dhe për pasojë, së bashku me ajrin marrin edhe helme të ndryshme për shëndetin. Burimi kryesor i ajrit të pastër janë sipërfaqet e gjelbra. Sipërfaqja e gjelbër dhe e mirëmbajtur është kryesisht nën kompetencën e komunave. Cilësia e ajrit, si pasuri elementare, që ndikon drejtpërdrejt në shëndetin e banorëve të komunës, është e varur nga rezultatet e qeverisjes lokale në shtimin e sipërfaqeve me bimë dhe ruajtjen e ambientit jetësor.

**Pasuria nëntokësore.** Ndahet në dy kategori kryesore: e metaleve dhe jometaleve, me origjinë magmatike dhe pasuria energjetike si lignit dhe nafta. Pasuria nëntokësore është e shtrirë kryesisht në rrafshin e Kosovës, ndërsa ajo mbitokësore hidrike, në rrafshin e Dukagjinit. Pasuria nëntokësore, sikur ajo mbitokësore krijojnë potencialin e zhvillimit ekonomik të komunave përkatëse. Në procesin e themelimit të komunave, qëndrueshmëria ekonomike e komunës, është parim themelor, sipas KEVQL. Pasuria nëntokësore është pasuri shtetërore dhe komuna nuk ka kompetenca në menaxhimin e saj. Komuna mbledhë një taksë vjetore nga kompanitë të cilat veprojnë në komunën e tyre dhe një numër i popullatës gjen punë në këto kompani, që është një përparësi e komunës. Problemi qëndron se kjo taksë nuk alokohet me rregull nga PQ në komunat përkatëse.

---

<sup>19</sup> MAPL - Analizë: “Regjistrimi i Popullsisë dhe Qeverisja Lokale”, Prishtinë 2012, fq. 13.

## **Organizimi i Komunave**

Komuna, si njësi themelore apo bazike e qeverisjes lokale, përfaqëson një unitet administrativ-territorial dhe bashkësi banorësh. Ajo përbëhet prej dy organeve themelore: Kuvendit të Komunës dhe Kryetarit të Komunës. Mënyra e organizimit të këtyre dy organeve e mundëson funksionimin komplementar të njëra tjetrës dhe që të dy organet zgjedhen drejtpërdrejt nga vota e qytetarëve.

### Zgjedhjet lokale

Sistemi zgjedhor udhëhiqet nga parimet demokratike, sipas të cilave qytetarë ka të drejtë të zgjedhë dhe të jetë i zgjidhur, të votojë i lirë, në mënyrë të fshehtë dhe vota e tij të jetë e sigurt, e drejtpërdrejt dhe e barabartë. Subjektet politike dhe kandidatët e pavarur kanë mundësi të organizojnë fushatë parazgjedhore në një kohë optimale për të shpalosë programin e tyre.

Sistemi zgjedhor është proporcional dhe i hapur çka do të thotë se anëtarët e kuvendit të komunës zgjidhen në bazë të listave të hapura, ku qytetari ka mundësi të votojë për kandidatin e tij/saj të preferuar. Që të shmanget çfarëdo parregullsie, listat duhet të jenë të certifikuara nga Komisioni qendror Zgjedhor (KQZ). Komuna përfaqëson një zonë të vetme zgjedhore. Numri i anëtarëve të kuvendit caktohet në bazë të numrit të banorëve nëpërmjet një formule standarde. Në kuvend duhet të sigurohet pjesëmarrja e gjinisë pakicë prej së paku 30% të anëtarëve të kuvendit. Sistemi zgjedhor iu mundëson të drejtën e ankesës të gjithë atyre që pretendojnë se iu është keqpërdorë vota e tyre. Kuvendi i komunës konstituohet pas certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve nga ana e KQZ.

## **Kuvendi i Komunës**

Kuvendi i Komunës përbëhet nga anëtarët e tij, të zgjedhur drejtpërdrejt nga qytetarët e komunës përkatëse, me mandat 4 vjeçar. Përfaqësimi i qytetarëve bëhet në bazë të një formule, që u siguron përfaqësim qytetarëve në vendimmarrje. Kuvendi udhëhiqet nga Kryesuesi i Kuvendit, për dallim nga rregulloret e UNMIK-ut , sipas të cilave është udhëhequr nga Kryetari i Komunës. Tani Kuvendi ka vetëm dy komitete të përhershme, ndërsa me Rregulloren 2007/30, kishte 7 komitete të përhershme. Komitetet tjera themelohen sipas nevojës dhe janë të përkohshme. Komitetet e ndihmonin Kuvendin në ngritjen e punës profesionale të tij dhe kanë funksione të njëjta në secilën komunë. Përvojat ndërkombëtare flasin për emërtime dhe numër të ndryshëm të tyre, por mesatarisht numri i tyre është pesë, ndërsa funksionet e tyre janë të ndryshme varësisht nga specifikat e komunave.

**Tab. 3. Organizimi i kuvendit të komunës në bazë të kritereve të brendshme**

| <b>Struktura organizative</b>             | <b>Rregullorja 2000/45</b>   | <b>Rregullorja 2007/30</b>   | <b>Ligji për VL/2008</b>   |
|---|--|--|--|
| <b>Zgjedhja e anëtarëve të kuvendit</b>   | <i>Mesatarisht 1100 qytetar përfaqësohen me 1 anëtar në kuvend</i> | <i>Mesatarisht 1100 qytetar përfaqësohen me 1 anëtar në kuvend</i> | <i>Mesatarisht 1100 qytetar përfaqësohen me 1 anëtar në kuvend</i> |
| <b>Kompetencat e kuvendit</b>             | <i>Miratimi i akteve me karakter të përgjithshëm</i>               | <i>Miratimi i akteve me karakter të përgjithshëm</i>               | <i>Miratimi i akteve me karakter të përgjithshëm</i>               |
| <b>Kryesuesi i kuvendit</b>               | <i>Kryetari i komunës</i>  | <i>Kryetari i komunës</i>  | <i>Kryesuesi i kuvendit</i>  |
| <b>Zavendës kryesuesi i kuvendit</b>      | <i>Zavendëskryetari</i>  | <i>Zavendëskryesuesi i parë dhe zavendëskryesuesi i dytë</i>       | <i>Zavendëskryesuesi i komuniteteve</i>                            |
| <b>Komitetet e përhershme të kuvendit</b> | <i>3 komitete të përhershme</i>                                    | <i>7 komitete të përhershme</i>                                    | <i>2 komitete të përhershme</i>                                    |

Puna e kuvendit në përgjithësi është në funksion të asaj për çfarë është themeluar. Kuvendi është i ndërtuar nga përfaqësuesit e subjekteve politike ku vendos shumica. Në rastet kur subjekti politik nuk e krijon shumicën e nevojshme në kuvend, ekziston mundësia e krijimit të koalicioneve me subjektet tjera politike dhe kështu plotësohet parimi themelor i vendosjes së shumicës. Opozita në të shumtën e rasteve e kryen funksionin e saj në korrigjimin e punës së pozitës në kuvend. Nuk vërehet se opozita luan rolin pro-aktiv me propozimet alternativave për zgjedhjen e problemeve dhe zhvillimin e komunës. Sistemi i votimit me shumicën e thjeshtë dhe me shumicën e cilësuar, mundëson miratimin e akteve komunale në përputhje me parimin e vlefshmërisë dhe ligjshmërisë. Kuvendi miraton aktet komunale, planet financiare dhe zhvillimore, raportet e punës dhe dokumente tjera me rëndësi për interesin e përgjithshëm të komunës, të cilat i propozon ekzekutivi i komunës. Transparenca e punës së kuvendeve është rritë nëpërmjet transmetimit të mbledhjeve të kuvendit në mjetet e informimit.

## **Kryetari i Komunës**

Është autoriteti kryesor ekzekutiv në komunë. Kalimi i zgjedhjes së Kryetarit prej përfaqësuesve të qytetarëve në kuvend, në zgjedhje të drejtpërdrejt nga qytetarët e komunës përkatëse, ka shtuar kompetencat dhe përgjegjësit e tij/saj në përfaqësimin dhe qeverisjen e komunës. Kryetari merr të gjitha kompetencat ekzekutive në komunë, emëron nënkryetarët e tij dhe drejtorët e drejtorive të administratës komunale. Kryetari krijon politika, organizon dhe udhëheq punën e komunës, menaxhon buxhetin dhe mbikëqyrë punën e komunës, por nuk ka mekanizma të qartë të llogaridhënies. Në aspektin organizativ, kryetari i komunës si organ ka strukturë të përzier organizative, të emëruarve politik dhe të shërbyesve civil.

Për ushtrimin e të gjitha këtyre kompetencave, kryetari themelon zyra të ndryshme për punë administrative. Me përshkrimin e kompetencave të zgjeruara dhe me mënyrën e zgjedhjes së kryetarit, më shumë shkohet drejt një organi autonom se sa të një organi vetëqeverisës lokal. Rrjedhimisht kryetari merr edhe rolin e mbikëqyrjes së zbatimit të vendimeve të kuvendit të komunës duke qenë përgjegjësi kryesor për punën e komunës dhe zbatimin e akteve të kuvendit. Në aspektin organizativ kryetari nuk ka konflikte funksionale me kuvendin e komunës.

## **Administrata komunale**

Administrata e komunës është e ndërtuar dhe e organizuar në drejtori, të cilat udhëhiqen nga drejtorët e emëruar nga kryetari i komunës<sup>20</sup>. Në secilën drejtori punojnë shërbyesit civil, të cilët zgjedhen në bazë të konkursit. Administrata e komunës përbëhet prej komponentës politike, drejtorëve, dhe nga komponenta civile. Udhëheqësi i personelit, nuk e ka të qartë pozitën e tij/saj. Drejtorët e drejtorateve më parë kanë qenë shërbyes civil dhe e tërë administrata ka qenë e udhëhequr nga Kryeshefi Ekzekutiv, po ashtu shërbyes civil, mirëpo i zgjedhur nga kuvendi komunal.

Edhe pse komunat kanë të njëjtat kompetenca dhe përgjegjësi, ato kanë numër të ndryshëm të drejtorive. Numri i përgjithshëm i drejtorive komunale në nivel vendi është 318, ndërsa mesatarja është 9. Numrin më të madh të drejtorive e ka Mitrovica dhe Peja (14), ndërsa numrin më të vogël të drejtorive e ka Klllokoti (5) dhe Mamusha (6). Emërtimi i drejtorive është i ndryshëm nga komuna në komunë. Drejtorit të cilat në shumicën e komunave kanë organizim dhe emërtim të njëjtë janë: Drejtorati për shëndetësi dhe mirëqenie sociale (në 31 komuna), Drejtorati për arsim dhe Drejtorati për rini kulturë dhe sport (në 25 komuna), Drejtorati për inspektion dhe Drejtorati i administratës (në 20 komuna), ndërsa drejtoratet tjera kanë emërtime të ndryshme në

---

<sup>20</sup>Kuvendi i Kosovës: “*Ligji për Vetëqeverisjen Lokale*”, neni 62, pika 62.1 dhe 62.2.

shumicën e komunave. Emërtimi i ndryshëm i drejtorateve shpesh herë shkakton probleme në komunikim, mbledhjen, përpunimin dhe ruajtjen në formë standarde të të dhënave.

Në përputhje me kompetencat që ka komuna, kompetencat e deleguara dhe ato të zgjeruara, administrata komunale lloje të ndryshme të shërbime. Komunat për shërbimet me natyrë të përafërt i kanë organizuar në drejtorate përkatëse, që më së shumti janë 14 dhe më së paku 5. Nuk ka një standard se cilat shërbime organizohen në drejtoratet përkatëse. Kjo tregon për një sistem të hapur të organizimit të administratës, që i pengon komunat të bashkërendojnë më lehtë shërbimet e përbashkëta. Për të vlerësuar se si PL është duke i ofruar këto shërbime për qytetarët, MAPL ka zhvilluar 95 tregues për 15 fusha të shërbimeve dhe organizon anketa me qytetarët për vlerësimin e shkallës së kënaqshmërisë së tyre.

Në administratën e komunës, krahas drejtorateve, ekzistojnë edhe zyra të ndryshme, që janë të lidhura me punën e kryetarit ose me drejtorit e ndryshme. Numri i përgjithshëm i zyrave në nivel të vendit është 137, ndërsa mesatarja e zyrave për një komunë është 4. Numër më të madh të zyrave ka Podujeva dhe Peja (11), ndërsa 8 komuna nuk kanë zyra fare. Në të shumtën e rasteve zyrat janë të themeluara me U.A të ministrive të linjës ose me rregullore për organizim të brendshëm të komunës.

Në administratën komunale punojnë kryesisht shërbyesit civil, të cilët krijojnë marrëdhënien e punës, të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre me Ligjin për Shërbimin Civil. Numri i të punësuarve në komuna është i caktuar me Vendimin Qeverisë Nr. 10/46. Ky numër është i përcaktuar në dy baza: numri i garantuar prej 55 të punësuarve dhe numri shtesë në bazë të numrit të banorëve të komunës. Komunave me mbi 100.000 banorë, u takon 1 zyrtarë në 750 banorë, ndërsa komunave nën 100.000 banorë, u takon 1 zyrtarë në 620 banorë. Me regjistrimin e ri të popullsisë numri i të punësuarve do të ndryshojë.

Komunat formalisht i kanë të gjitha të drejtat për punësimin dhe menaxhimin e tyre në sektorët publik, por vërehet një mundësi e tërthortë e ndikimit të ministrive të linjës nëpërmjet këshillave të përbashkëta ekzekutive të institucioneve publike, si në arsim, shëndetësi etj.



## **OFRIMI I SHËRBIMEVE**

Funksioni kryesor i sistemit të VQL në Kosovë është i orientuar në ofrimin e shërbimeve sa më cilësore. Shërbimet krijojnë lidhjen ndërmjet PL dhe të qytetarëve dhe në të njëjtën kohë, PL e ruan lidhjen edhe me PQ. Për ofrimin e shërbimeve administrata lokale në Kosovë ka angazhuar 6224 të punësuar, të cilët kanë kapacitete të nivelit të mesëm për përmbushjen e kërkesave të palëve të interesuara<sup>21</sup>. Shërbimet janë produkte të cilat komuna u ofron qytetarëve të saj në bazë të nevojave dhe kërkesave të vlerësuara dhe të sanksionuara me akte administrative dhe ligjore.

### **Shërbimet që Ofron Komuna**

Në bazë të vlerësimit të nevojave që kanë qytetarët, grupet e ndryshme të interesit dhe komunitetet, MAPL nëpërmjet kornizës ligjore dhe dokumenteve tjera administrative i ka sanksionuar fushat kryesore në të cilat komunat ofrojnë shërbime për qytetarët dhe grupet e interesit. Shërbimet komunale ndahen në tri kategori:

- Shërbimet themelore;
- Shërbimet e transferuara dhe
- Shërbimet e specializuara.

Shumë shtete evropiane kanë kaluar në ofrimin e shërbimeve të integruara.

### **Shërbimet Themelore**

Në bazë të analizave dhe vlerësimeve të bëra, janë identifikuar fushat themelore për të cilat qytetarët kanë nevojë parësore që komuna t'iu ofrojë shërbime. Fushat themelore të ofrimit të shërbimeve janë të lidhura me të drejtën e plotë të komunës për ofrimin e këtyre shërbimeve (kompetencat vetanake). Fushat kryesore themelore të shërbimeve komunale mund listoni në tabelën në vazhdim.

---

<sup>21</sup> MAPL: “Raport i Vlerësimit të Kapaciteteve në Komuna”, Prishtinë 2011.

**Tab. 4.** Lista e shërbimeve themelore

| Shërbimet themelore   |   |
|---|---|
| 1. Krijimi i kushteve për zhvillim ekonomik lokal   | 9. Ofrimin e banimit publik të qytetarëve   |
| 2. Krijimi i kushteve për mjediset urbane dhe rurale  | 10. Adresat, nëpërmjet emërtimit të rrugëve, shesheve dhe vendeve publike                                       |
| 3. Përkrahja e qytetarëve në shfrytëzimin e planifikuar të tokës dhe zhvillimin e bujqësisë | 11. Promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut   |
| 4. Krijimi i kushteve për ndërtim të vendbanimeve, sipas standardeve të ndërtimit           | 12. Licencimin e shërbimeve publike: si aktivitetet kulturore, strehimin, tregjet, ushqimin, transportin publik |
| 5. Krijimin dhe mbrojtjen e një mjedisi të shëndosh për qytetarët                           | 13. Mirëmbajtja e hapësirave publike  |
| 6. Ofrimi i shërbimeve publike dhe komunale   | 14. Ofrimi i kujdesit shëndetësor primar dhe të shëndetësisë publike  |
| 7. Ofrimi i ndihmës në rastet e emergjencave lokale   | 15. Promovimi dhe zhvillimi i turizmit dhe i kulturës   |
| 8. Ofrimi i arsimimit publik parafillorë, fillorë, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë   | 16. Ofrimi i shërbimeve sociale   |

Këto janë shërbimet që komuna ka obligim themelor t'iu ofrojë qytetarëve me aktin e themelimit të saj. Në kuadër të secilës prej këtyre fushave ofrohet një numër më i madh i shërbimeve specifike për qytetarët.

#### Shërbimet administrative

Është njëra prej shërbimeve kryesore që ofrohet nga komuna. Komunat e kanë të angazhuar numrin më të madh të BNj në ofrimin e këtij shërbimi. Komunat dhe MAPL kanë ndërtuar infrastrukturë të re, programe kompjuterike (TI), aftësim të BNj me qëllim të rritjes së kapaciteteve për ofrim cilësor të shërbimeve administrative. Tani po bëhet digjitalizimi i ofrimit të shërbimeve dhe duke e thjeshtësuar procedurën dhe pritjet e qytetarëve. MAPL ka vlerësuar performancën e komunës në ofrimin e këtyre shërbimeve dhe në të njëjtën kohë ka matë kënaqshmërinë e qytetarëve.

#### Menaxhimi i financave lokale

Komunat, krahas të drejtës për ushtrimin e kompetencave kanë të drejtë të kenë burime të mjaftueshme financiare dhe t'i menaxhojë ato në mënyrë të pavarur dhe në përputhje

me ligjet në fuqi<sup>22</sup>. Komunat kanë të drejtë të menaxhojnë pasurinë e tyre komunale dhe të gjenerojnë të hyra vetanake. Buxheti i komunave buron prej të hyrave vetanake të komunave, prej granteve qeveritare dhe donacioneve të ndryshme. Ndërsa struktura buxhetore është e përbërë prej tre komponentëve kryesor: pagat dhe mëditjet, mallrat dhe shërbimet dhe shpenzimet kapitale. Struktura e sistemit financiar e përcakton orientimin e sistemit të vetëqeverisjes. Komuna, varësisht nga kompetencat që i ushtron, merr<sup>23</sup>:

- Grante të përgjithshme;
- Grante për kompetencat e shtuara;
- Transferet për kompetencat e deleguara;
- Grante të jashtëzakonshme;
- Ndihma financiare nga Serbia (për komunitetin serb)
- Të hyra nga huamarrjet e komunave

### Zhvillimi ekonomik lokal

Derisa në vitin 1950 Kosova ishte një vend tipik agrar (70% të BPV ishte nga Bujqësia kooperativiste), tani është transferuar në një vend ku dominon ekonomia e tregut me pjesëmarrje të lartë të biznesit privat (51% të BPV)<sup>24</sup>. Organizimi i sektorit ekonomik në komunë është i rregulluar me një kornizë ligjore e cila iu mundëson qytetarëve, organizimin e tyre në veprimtari të ndryshme biznesore. Deri tani nuk kemi një vlerësim të zhvillimit ekonomik të komunave. Vlerësimi i kësaj fushe bëhet nëpërmjet treguesve të tërthortë ekonomik: si numri i bizneseve që veprojnë në komunë, numri i të papunëve, shkalla e financimit në këtë fushë etj.

Komunat kanë marrë kompetencat për licencimin e bizneseve. Numri dhe llojet e tyre, prej vitit në vit po rriten. Llojet kryesore të veprimtarisë biznesore në komunat e RK, janë: *biznese individuale, ortakëri e përgjithshme, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, ortakëri e kufizuar, shoqëri aksionare, kompani e huaj, ndërmarrje shoqërore, ndërmarrje publike, kooperativë bujqësore dhe organizatat që janë në përgjegjësi të AKM*. Numri i gjithëmbarsuem i veprimtarive biznesore në komuna është 123,151 prej të cilave 108,725 apo 88.3% janë biznese individuale, 9730 ose 8% janë shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, ndërsa kompani të huaja janë 614 ose 0.5%. Mesatarja e ekonomive biznesore për komunë është 4105, me një rritje mesatare prej 994 biznese në vit. Mbi mesataren e vendit qëndrojnë vetëm 7 komuna, prej tyre Prishtina ka më së shumti 30498 biznese, ndërsa 23 komuna kanë më pak biznese se sa mesatarja e vendit apo 77% e tyre.

---

<sup>22</sup> Kuvendi i Kosovës: “Ligji për Financat e Pushtetit Lokal”, Prishtinë, 2009.

<sup>23</sup> Kuvendi i Kosovës: “Ligji për Financat e Pushtetit Lokal”, Prishtinë, 2009, neni 7.

<sup>24</sup> MTI: “Strategjia Afatmesme e Zhvillimit të Kosovës”, 2004 – 2008.

Komunat kanë arritur që të krijojnë një mjedis relativisht miqësor për investime, përkrahin bizneset e vogla dhe të mesme (108,725), inkurajimi i ndërmarrjeve të reja, tërheqjen e investimeve kombëtare dhe ndërkombëtare (614 biznese të huaja), përmirësimi i infrastrukturës fizike, përkrahja e bizneseve emergjente apo të përkohshme etj.

### Transporti Publik

Është pjesë shumë e rëndësishme e zhvillimit ekonomik të një komune apo të një vendi. Komunat kanë për obligim të menaxhojnë transportin publik të qytetarëve. Shërbimi i transportit publik është mjaft specifik dhe i ndërlikuar që kërkon kapacitete njerëzore të nivelit të lartë në menaxhimin e këtij lloji shërbimi.

Transporti publik përfshinë shkallën e mbulimit, bartjen e qytetarëve me kohë dhe të sigurt. Kryesisht komunat kanë plane për rregullimin e transportit publik dhe transporti i qytetarëve bëhet kryesisht nga kompani të licencuara. Kur të krahasohen të dhënat me vitin 2009, mund të konstatojmë se kemi një ngritje të kapaciteteve në këtë fushë. Problem mbetet operimi i kompanive të palicencuara.

### Kushtet në mjediset urbane dhe rurale

Qëllimi kryesor i funksionimit të VQL është përmirësimi i kushteve të jetesës në vendbanimet urbane dhe rurale të qytetarëve të komunave të tyre. Në këtë drejtim komunat kanë shënuar rezultate të rëndësishme, por ka mbetur edhe shumë për të bërë. Komunat së bashku me MAPL dhe donatorët e ndryshëm kanë investuar në rregullimin e rrugëve, trotuareve, ndriçimit publik dhe të parkingjeve publike.

Matjet dhe vlerësimet e bëra nga MAPL dhe USAID tregojnë se kemi një përmirësim të rregullimit të rrugëve, nga viti 2010 - 2012 për 16% dhe më e rëndësishmja është se kënaqshmëria e qytetarëve është më e lartë se sa vlerësimet zyrtare të MAPL. Rrugët funksionojnë mirë.

### Menaxhimi i tokës dhe zhvillimi i bujqësisë

Toka si pasuri e komunave, është e ndarë në tre grupe: toka bujqësore me 53%, toka pyjore me 42% dhe toka tjetër e papunuar dhe e ndërtonuar me vendbanime 5%. Kosova aktualisht i ka 195,348 ha tokë të punueshme. Tokë bujqësore në pronësi private është 88,6 %, ndërsa pjesa tjetër është në pronësi të ndërmarrjeve shoqërore. Sipërfaqja e tokës për kokë të banorit vlerësohet se është rreth 0,15-0,18 ha. Bazuar në të dhënat statistikore madhësia mesatare e fermës për familje është 2,2 - 2,4 ha, e ndarë në 6 - 8 ngastra<sup>25</sup>. Prej

---

<sup>25</sup> MMPH: "Gjendja e Mjedisit në Kosovë", Prishtinë, 2004, fq. 25.

tyre më së shumti mbillet grurë 40%, pastaj me misër kokërr 25%, me perime 8% etj<sup>26</sup>. Mesatarja e hektarëve për komunë në nivel të vendit është 5581 ha. Shumica e komunave apo 54% e tyre kanë më shumë ha të tokës bujqësore se mesatarja e vendit. Podujeva ka më së shumti tokë bujqësore 16380 ha, pason Skenderaj me 16000 ha etj. Kosova ende nuk ka mekanizma të qëndrueshëm për menaxhimin e tokës dhe kjo ka sjellë probleme në shfrytëzimin e saj sipas destinimit dhe vazhdimisht po zvogëlohet ajo.

Aktualisht janë katër sfida kryesore me të cilat përballlet sektori i bujqësisë në Kosovë<sup>27</sup>:

- **Ndërrimi i destinimit të tokës bujqësore** është njëri ndër kërcënimet më serioze që i bëhen të ardhmes së bujqësisë në Kosovë. Vlerësohet se mbi 1.000 hektarë në vit janë konvertuar nga toka bujqësore në tokë ndërtimore në kohën para lufte, kurse tani kjo shifër është shumë më e madhe.
- **Fragmentimi i parcelave** është problem tjetër i madh, sipërfaqja e përgjithshëm për amvisni e ndarë në shumë parcela që shpesh paraqet kufirin e poshtëm të arsyeshmërisë ekonomike për t'i punuar ato.
- **Ndotjet industriale** nga Kompleksi "TREPÇA", Termoelektranat "Obiliq", por edhe ndotës tjerë më të vegjël, paraqesin kërcënim serioz për bujqësinë e Kosovës.
- **Kontaminimi i ujit dhe i tokës** nga deponitë e mbeturinave poashtu paraqesin problem mjedisor me implikim direkt në zhvillimin e bujqësisë në Kosovë.

**Mbrojtja e pyjeve** është shërbim i deleguar nga niveli qendror në komuna. Sistemi aktual i mbrojtjes së pyjeve është rregulluar me LVL<sup>28</sup> dhe Ligjin për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Mbrojtjet e Kosovës<sup>29</sup>. Tokat pyjore mbulojnë 42% të territorit të Kosovës<sup>30</sup>. Pyjet janë burim i zhvillimit ekonomik dhe i përmirësimit të cilësisë së jetës së qytetarëve duke thithë CO<sub>2</sub> dhe pasurimin e ajrit me O<sub>2</sub>. Tokat pyjore që janë në pronësi publike, përfshijnë 40% të sipërfaqes së pyjeve, pyjet private 38% dhe 26% me pronësi të padefinuar. Komunitat obligohen që ta përparojnë mjedisin jetësor dhe pasurinë e komunës me ripërtëritjen, mirëmbajtjen dhe menaxhimin profesional të pyjeve. Komunitat japin leje për prerjen e masës drunore në përputhje me standardet e përcaktuara nga Agjencioni i Pyjeve të Kosovës (APK). Nga kjo komunitat gjenerojnë të hyra vetanake në shumën prej 30% nga totali i shitjes së masës drunore.

**Pyllëzimet.** Gjatë viteve 1999 - 2002 janë pyllëzuar 1988 ha, ndërsa gjatë vitit 2003 janë pyllëzuar 351 ha. Sipërfaqja e pyllëzuar është shumë e vogël në krahasim me prerjen e

---

<sup>26</sup> MBZHR: "Prodhimtaria bujqësore sipas komunave e shprehur në hektar", Prishtinë, 2012.

<sup>27</sup> MMPH: "Gjendja e Mjedisit në Kosovë", Prishtinë, 2004, fq. 25.


<sup>28</sup> MAPL: "Ligji për Vetëqeverisje Lokale", Prishtinë 2008, neni 18.

<sup>29</sup> Kuvendi i Kosovës: "Ligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Mbrojtjet e Kosovës", Prishtinë 2003.

<sup>30</sup> MMPH: "Plani Hapësinor i Kosovës", Prishtinë 2010, fq. 48.

pyjeve. Sipas MBPZHR-Agjencioni Pyjor i Kosovës, në vit prehen 185.890 metra kub dru teknik dhe për djegie. Sipas burimit të njëjtë në vitin 2001 dru teknik janë prerë 30.195 metra kub ndërsa dru zjarri 145.695 metra kub. Po kaq llogaritet të jetë sasia e drunjve të prerë në mënyrë ilegale. Bazuar në Raportin e Agjencisë Pyjore të Kosovës për vitin 2003 vetëm nga prerjet ilegale janë evidentuar 10. 471m<sup>3</sup> dru, shprehur në vlerë financiare 1.713.132,00 € për çka janë ngritur 5.421 fletëparaqitje në gjykatat kompetente nga të cilat janë zgjidh vetëm 56 raste.

## Harta 2. Zënia e tokës bujqësore<sup>31</sup>



Komuna është e obliguar që të organizojë mbrojtjen e prerjes së pakontrolluar të pyjeve nëpërmjet rojës së pyjeve. Me ligjin e ri janë përmirësuar kushtet për mbrojtjen e pyjeve. Derisa më parë 1 person ishte përgjegjës për 1500 – 2500 hektarë pyll, tani 1 person është përgjegjës vetëm për 1000 hektar. Komunat problemin më të madh e kanë

në funksionimin e mbrojtjes së pyjeve. Po thuaj asnjë komunë nuk ka mjete buxhetore për angazhimin e stafit të mjaftueshëm në përputhje me standardet e përcaktuara. PQ nuk i ka bartë kapacitetet e duhura së bashku me delegimin e kompetencës në komunë. Pyjet po shkatërrohen, ekonomia e komunës po zvogëlohet, mjedisi po degradohet, sasia e ujit të akumuluar po zvogëlohet dhe po rritet rreziku nga vërshimet periodike.

**Sistemi i zonave të mbrojtura** në Kosovë përfshinë sipërfaqe prej 46.000 ha ose 4.27% të territorit të saj. Këtë sistem të zonave të mbrojtura e përbëjnë 1 Park Kombëtar, 11 rezervate të natyrës, 37 monumente të natyrës dhe 2 peizazhe të mbrojtura<sup>32</sup>.

**Prona publike.** Menaxhimi i pronës publike është një veprimtari e ndërlikuar që ngërthen në veti shumë faktorë dhe si e tillë ende ka probleme të theksuara. Kështu 25% e të anketuarve në komuna mendojnë se komuna ka një regjistër jo të plotë të pronës publike dhe se prona publike komunale menaxhohet në mënyrë joefikase. Komuna ka një bazë të të dhënave për pronën publike komunale e cila përdoret *ad hoc* dhe nuk rifreskohet rregullisht. MAPL i ka qartësuar përgjegjësitë e komunave me Ligjin për Dhënie në Shfrytëzim të Tokës. Në bazë të analizave të bëra, shumica e shkeljeve që janë bërë nga

<sup>31</sup> MMPH: “Plani Hapësinor i Kosovës”, Prishtinë 2010, fq. 48.

<sup>32</sup> MMPH: “Gjendja e Mjedisit në Kosovë”, Prishtinë, 2004, fq. 54.

komunat kanë të bëjnë me pronat dhe transferimin e tokës bujqësore në tokë të banimit. Në këtë aspekt është paraqitur problemi i mungesës së pronës komunale në vendbanimet e urbanizuara.

### Zbatimi i standardeve të ndërtimit

Një prej matjeve kryesore të efektshmërisë, punës së mirë apo të dobët të një komune është urbanizmi. Kapacitetet profesionale të personelit që punon në sektorin e urbanizmit dhe posedimi i Rregullativave të shumta që komunat duhen të kenë në sektorin e urbanizmit janë të ndërlidhura me njëra-tjetrën pashmangshmërisht. Me gjithë përparimet e bëra në zhvillimin e planeve zhvillimore, urbane dhe rregullative, prapë një përqindje e konsiderueshme (32%) e të anketuarve mendojnë se planet ose janë në procedurë të miratimit ose nuk kanë plane zhvillimore, por edhe kur ekzistojnë shumë pak kanë ndikim në vendimet e ekzekutivit apo nuk zbatohen.

### Mbrojtja e mjedisit

Komunat e Republikës së Kosovës kanë një mjedis të pasur me pyje dhe sipërfaqe tjera të gjelbra natyrore ose si monokultura të kultivuara nga njeriu. Mjedi është relativisht i begatë me ujë dhe ajër të pastër. Niveli qendror dhe ai lokal kanë zhvilluar shumë dokumente strategjike dhe rregullative ligjore për mbrojtjen dhe përparimin e mjedisit jetësor, por përgjithësisht nuk zbatohen në mënyrën më të mirë.

### Shërbimet publike dhe komunale

Një grup tjetër i shërbimeve publike janë: ujësjellësi, kanalizimi, menaxhimi i mbeturinave, transporti publik, mirëmbajtja e rrugëve dhe hapësirave publike dhe ndërmarrjet publike. Këto shërbime ndërlidhen me komunën nëpërmjet ndërmarrjeve publike, të cilat kanë përgjegjësi për ofrimin e shërbimeve publike dhe të emergjencave. Komunat kanë probleme të theksuara në ofrimin e këtyre shërbimeve, sepse statusi i ndërmarrjeve publike, të cilat i kryejnë këto shërbime, është relativisht i pavarur nga komuna dhe kompetencat e një komune janë të kufizuara në menaxhimin e tyre. Në vazhdim po i pasqyrojmë të dhënat për secilin shërbim.

**Ndërmarrjet publike (NP).** Bordi i Drejtorëve. Kryesisht 63% e rasteve komunat i kanë ngritur të gjitha organet për menaxhimin e NP dhe janë funksionale, megjithatë në afër 20% të rasteve komunat i kanë ngritur Komisionet Komunale të Aksionarëve por nuk janë funksionale, nuk është funksional as Bordi i Drejtorëve. Po ashtu në afër 20% të rasteve komunat nuk kanë ngritë Komisionin Komunal të Aksionarëve, Bordi i Drejtorëve nuk është themeluar dhe ndërmarrjet publike nuk kanë rregullore të punës.

*Furnizimi me ujë, kanalizimi dhe mbeturinat.* Ujë është pasuri shtetërore, e cila nuk është e bollshme për qytetarët e komunave të RK. Mesatarisht 1600 m<sup>3</sup> ujë për 1 banor<sup>33</sup>. Për përmirësimin e furnizimit të qytetarëve me ujë, janë formuar liqene artificiale, në komunën e Prishtinës (Liqeni i Badovcit), në Podujevë (Liqeni i Batllavës), në Zubin Potok (Gazivoda), në Gjilan (liqeni i Perlepticës dhe i Livocit) dhe liqeni i Radoniqit në Gjakovë. Për nga sasia e ujit të akumuluar më së shumti ka Gazivoda 390 ml m<sup>3</sup>, Radoniqi me 113 mil m<sup>3</sup>, Badovci 31 mil m<sup>3</sup>, Batllava 30 mil m<sup>3</sup> etj<sup>34</sup>. Nga akumulimet sipërfaqësore me ujë të pijes furnizohen njëmbëdhjetë komuna të Kosovës (Mitrovica, Vushtrria, Skenderaj, Drenasi, Podujeva, Prishtina, Kastrioti, Gjilani, Gjakova dhe Rahoveci) për çka angazhohet një sasi prej afër 60 x 106 m<sup>3</sup> ndërsa vendbanimet tjera furnizohen nga ujërat nëntokësore dhe burimet. Vendbanimet rurale furnizohen nga puset dhe ujësjellësit lokal, duke marr ujin përmes kaptimit të burimeve<sup>35</sup>. Sasia e ujit është e pamjaftueshme për pije, për zhvillim normal të bujqësisë dhe veprimtarive tjera të qytetarëve.

Ujë si elementi kryesor i jetës, po u ofrohet qytetarëve gjithnjë e më shumë dhe më cilësor. Ujë menaxhohet nga ndërmarrjet publike të ujësjellësve, me mbështetjen e drejtpërdrejt nga komunat e rajoneve përkatëse. Një numër i madh i qytetarëve është mbuluar me furnizim të ujit të pijes nëpërmjet ujësjellësit, ndërsa një numër i konsiderueshëm ende ujin e pijes e siguron nëpërmjet puseve. Po ashtu krahas ujit po instalohet edhe rrjeti i kanalizimit dhe menaxhimi i mbeturinave. Kapacitetet e ndërmarrjeve publike për menaxhimin e ujit, ujërave të zeza dhe mbeturinave nuk janë të plota.

Në bazë të informatave nga zyrtarët komunal, komunat kanë shumë projekte të parealizuara që kanë të bëjnë me shtrirjen e furnizimit me ujë të pijes, menaxhimin e ujërave të zeza, që përfaqëson një segment shumë problematik dhe të kushtueshëm, dhe menaxhimin e mbeturinave të ngurta. Ministria e MPH ka nxjerrë një Udhëzim Administrativ dhe ka zhvilluar një plan strategjik për menaxhimin e mbeturinave, ku parashihet ndërtimi kapaciteteve në komuna për realizimin e tyre. Në zonat urbane mbeturinat administrohen nga ndërmarrjet publike dhe janë të mbuluara deri 90%, ndërsa zonat rurale (që paraqesin mbi 60% të vendbanimeve), janë shumë pak të mbuluara me afro 10%<sup>36</sup>. Kështu, sipas të dhënave nga GTZ, lidhur me sasinë e mbeturinave të prodhuara në Kosovë, del se për vitin 2000-2001, janë prodhuar 1.2 kg/mbeturina urbane në ditë për kokë të banorit, përkatësisht 438 kg/kb/vit.

---

<sup>33</sup> MMPH: “*Plani Hapësinor i Kosovës*”, Prishtinë, 2010.

<sup>34</sup> MMPH: “*Plani Hapësinor i Kosovës*”, Prishtinë, 2010.

<sup>35</sup> MMPH: “*Gjendja e Mjedisit në Kosovë*”, Prishtinë, 2004, fq. 47.

<sup>36</sup> MMPH: “*Gjendja e mbeturinave në Kosovë*”, Prishtinë, 2003 – 2004, fq. 19 - 21.



Menaxhimi i mbeturinave ka shënuar përmirësime për 22%, por qytetarët nuk janë të kënaqur me ofrimin e këtij shërbimi. Pavarësisht të dhënave zyrtare të komunave, menaxhimi i mbeturinave ende nuk funksionon si duhet. Mjediset urbane dhe rurale janë të mbushura ende me mbeturina të llojeve të ndryshme.

### Menaxhimi i emergjencave

Ka të bëj me ofrimin e shërbimit emergjent në rastet e shkaktimit të zjarrit. Të dhënat e mëhershme tregojnë se ky shërbim nuk është mirë i konsoliduar në mungesë të kapaciteteve teknike dhe atyre njerëzore. K Pavarësisht se të gjithë treguesit flasin për një shkallë të mesme të performancës së komunave në ofrimin e këtij shërbimi, njësoj sikur edhe shërbimet tjera, MPB ua ka marrë këtë shërbim komunave dhe tani ai ofrohet nga strukturat përkatëse të kësaj ministrie. Kjo është e kundërligjshme.

### Ofrimi i shërbimeve arsimore

Në vlerësim janë përfshi të gjitha nivelet e shkollimit dhe veprimtaritë e shkollave që janë në përgjegjësi të komunave. Është fusha më e shtrirë e ofrimit të shërbimeve të qytetarëve, ku nevojiten mjete dhe BNj të konsiderueshme për sigurimin e funksionimit të saj. Institucionet arsimore (IA) përfaqësojnë industrinë e zhvillimit të një vendi. Në këto institucione prodhohet dija, që është kapital apo pasuria më e vlefshme e një shoqërie. Në RK ka gjithsej 1.161 shkolla parauniversitare (418.352 nx), prej tyre: 42 parashkolla, 998 fillore, 115 të mesme dhe 6 shkolla speciale. Numër më të madh të shkollave ka Prishtina, 80 shkolla, ndërsa numrin më të vogël e ka Mamusha, 3 shkolla. Prej 34 komunave, 9 komuna kanë 0.0 çerdhe, 1 komunë ka vetëm një shkollë fillore, 1 komunë ka vetëm 2 shkolla fillore dhe 8 komuna kanë vetëm nga 1 shkollë të mesme të lartë. Kjo jep të kuptojmë se 30% e komunave nuk ofrojnë mësim dhe edukim për fëmijët parashkollor dhe nuk e ushtrojnë kompetencën e tyre ligjore, ndërsa 27% e tyre ofrojnë në minimum arsim të mesëm të lartë.

Faktori më i rëndësishëm në funksionimin e sistemit arsimor janë BNj, të cilat as nuk janë të aftësuara mjaftë e as të licencuara për zbatimin e reformave në arsimin parauniversitar.

Komuna e Mitrovicës Veriore merr kompetenca shtesë në organizimin e arsimit të lartë (5 ISCED). Gjithashtu komunat me shumicë serbe fitojnë të drejtën të organizojnë mësimin sipas planprogrameve të një shteti tjetër (Serbisë). Kjo i sjellë qytetarët e të njëjtës komunë para dy sistemeve të arsimit. **Arsimi universitar.** Komuna e Mitrovicës së Veriut ka kompetencë për ofrimin e shërbimit arsimor të nivelit universitar. Atje funksionon Universiteti serb i Mitrovicës së Veriut, sipas planprogrameve të Serbisë. Nuk ka shënime nga MASHT se është krijuar Komisioni për Rishikimin e Planprogrameve as për nivelin parauniversitar e as për nivelin universitar.

### Ofrimi i shërbimeve shëndetësore

Organizimi i institucioneve të cilat ofrojnë shërbime mjekësore, në nivelin lokal janë: shërbimi parësor (26 Qendra Kryesore të Mjekësisë Familjare, 122 Qendra të Mjekësisë Familjare dhe 240 Ambulanta) dhe shërbimi dytësor ofrohet në 5 Spitale Rajonale dhe 2 spitale jopublike në Vushtrri dhe Ferizaj<sup>37</sup>.

Në bazë të kompetencave komunat ofrojnë shërbime parësore shëndetësore, që janë në menaxhim të komunave dhe janë pjesë e sistemit të përgjithshëm shëndetësor të vendit. Cilësia e ofrimit të shërbimeve primare, në radhë të parë varet nga komuna, por një pjesë e suksesit të tijë varet edhe nga hallkat e segmenteve tjera të sistemit shëndetësor që nuk janë përgjegjësi e komunës.

*Personeli mjekësor.* Standardet për ofrimin e shërbimeve mjekësore duhet të jenë më të lartat, kur kihet parasysh shëndeti i qytetarëve.

*Shëndetësia private.* Krahas shërbimit publik shëndetësor në territorin e komunave veprojnë edhe shumë ordianca dhe spitale private. Numri më i madh i tyre kanë leje për veprimtarinë e tyre dhe puna e tyre kontrollohet kohë pas kohe nga inspeksioni shëndetësor.

*Shëndetësia sekondare.* Në kuadër të shërbimeve shtesë, disa komuna serbe (Shterpca, Gracanica dhe Mitrovica e Veriut) kanë marrë të drejtën e ofrimit të shërbimeve dytësore shëndetësore. Këto komuna ende nuk janë duke iu ofruar shërbime shëndetësore dytësore qytetarëve nga se janë në proces të ndërtimit të kapaciteteve. Në bashkëpunim me qeverinë, donatorët, komunat me shumicë serbe janë në proces të ndërtimit të spitaleve dhe të pajisjeve me aparate përkatëse.

### Promovimi dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut

Fusha e të drejtave të njeriut paraqet një ndër obligimet kushtetuese themelore që duhet t'i ketë secila komunë dhe secili sektor brenda saj. Ndërtimi i kapaciteteve profesionale të të gjithë të punësuarve në komunë nuk mund të paramendohet pa inkuadrimin e sektorit të të drejtave të njeriut në parim me të gjitha konventat ndërkombëtare që kanë të bëjnë me liritë dhe të drejtat e njeriut, si dhe vetë Kushtetutën e Republikës së Kosovës, e cila i përcakton qartë liritë dhe të drejtat e njeriut e fokusuar edhe në grupet minoritare, gjinore, fetare etj.

Vendimmarrjet mbi çështjen e pakicave në komunat e RKS-së pas luftës janë përcjellë me hezitime dhe nganjëherë edhe probleme për shkak të specifikave politike.

---

<sup>37</sup> MMPH: “Plani Hapësinor i Kosovës”, Prishtinë, 2010, fq. 108.

Meqenëse Kushtetuta e Kosovës e garanton shumë-etnicitetin në shoqërinë kosovare, përdorimi i gjuhëve zyrtare në komuna ka qenë një prej angazhimeve të theksuara të agjendës së qeverive komunale. Prandaj ky seriozitet në zbatimin e ligjit për dygjuhësi është treguar edhe në komunat e RKS, ku vetëm shtatë për qind e të anketuarve deklarojnë se dokumentet që i nxjerrë komuna nuk përkthehen në gjuhën zyrtare, apo se nuk ka një sistem të qartë të përkthimit në gjuhët zyrtare të dokumentacioneve që nxjerrë komuna.

### Ofrimi i shërbimeve familjare dhe të mirëqenies sociale

Ekziston një shtresë e qytetarëve të cilët nuk kanë mundësi të sigurojnë vetë ekzistencën, andaj nevojitet ndihma e komunës dhe e shtetit. Komuna pranon grante nga Qeveria e ndanë një grantë për ofrimin e shërbimeve sociale shtresave me nevojë, por një pjesë të të hyrave vetanake edhe komuna mund t'ia dedikojë kësaj kategorie.

Fillimisht kjo kompetencë ishte e centralizuar dhe nga viti 2009, është bartur në komunë. Problemi qëndron se një pjesë e burimeve nuk është deleguar me rastin e bartjes së kësaj kompetence në komuna. Po ashtu problem tjetër është *menaxhimi i ndihmës sociale* si shërbim me kompetencë të deleguar.

### Rinia kultura dhe turizmi

Komunat ofrojnë shërbime edhe në fushën e kulturës dhe të sportit për rininë e tyre. Komunat kanë të themeluara qendrat kulturore, bibliotekat, terrenet dhe sallat sportive, stadiumet sportive, shoqëritë kulturore e artistike me qëllim që qytetarëve t'iu ofrojnë aktivitete të ndryshme kulturore dhe sportive. Në këtë fushë ka gjithashtu nivele të ndryshme të veprimtarive.

Njëra prej fushave e cila gjeneron të hyra vetanake për komunat dhe ndihmon zhvillimi komunal është turizmi. Që turizmi të jetë i zhvilluar, nevojiten plane zhvillimore afatgjata dhe infrastrukturë e mjaftueshme për zhvillimin e turizmit. Për këtë qëllim komunat kanë marrë ndihma të ndryshme edhe nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, si dhe nga donatorë të ndryshëm ndërkombëtar, në veçanti nga Komisioni Evropian. Këto kanë ndikuar në përmirësimin e kapaciteteve ekzistuese të komunave për zhvillimin e turizmit e në veçanti ekoturizmin.

Kjo pasuri është e shpërndarë në komuna të ndryshme të Kosovës dhe përfaqëson një potencial të madh turistik dhe ekonomik. Kjo pasuri u ka krijuar komunave lidhje turistike me vendet e rajonit dhe më gjerë. Deri tani RK ka 1181 monumente dhe lokalitete arkeologjike, që përfaqësojnë vlera të ndryshme kulturore, që janë të vjetra nga parahistoria e deri në shek. 20<sup>38</sup>.

---

<sup>38</sup> MKRS: “*Lista e Trashëgimisë Kulturore për Mbrojtje të Përkohshme*”, Prishtinë, 2012.

*Tab. 8. Kategoritë dhe numri i trashëgimisë kulturore në komuna, sipas kohës historike*

| Nr              | Kategoria / nënkategoria          | Numri       | Periudha  | Komuna            |
|-----------------|-----------------------------------|-------------|---|-------------------|
| <b>1</b>        | <b>Trashëgimia Arkeologjike</b>   |             |   |                   |
| a.              | Monument                          | 60          | 17% parahistori dhe antikë dhe 83% mesjetë                                    | 17                |
| b.              | Lokalitet arkeologjik             | 292         | 54% parahistori dhe antikë dhe 46% mesjetë. Mesatarja 9 lokalitete për komunë | 32                |
| <b>2</b>        | <b>Trashëgimia Arkitekturore</b>  |             |   |                   |
| a.              | Monument                          | 827         | Shumica e tyre janë prej shekullit XVI - XX.                                  | 32                |
| b.              | Fushat e konservimit arkitekturor | 2           | Ska datë  | Prizren & Rahovec |
| <b>Gjithsej</b> |                                   | <b>1181</b> |   | <b>32</b>         |

Mesatarja e vendit është 37 monumente dhe lokalitete arkeologjike për komunë, ndërsa përqëndrimi më i madh i tyre është në Gjakovë (164), Prizren (145), Pejë (116), Prishtinë (104), Gjilan (62), Istog (56), Ferizaj (40), Viti (32), Podujevë (31) etj. Me Ligjin për Trashëgëmi, komunat nuk kanë ndonjë përgjegjësi të theksuar. Me Pakon e Ahtisarit, kishat serbe fitojnë statusin e “Zonave të Mbrojtura”, që mbikëqyren nga Këshilli Zbatues Mbikëqyrës, në përkrahje të Sekretaritit si trup teknik i Këshillit.

### Mbrojta e trashëgimisë kulturore

Kjo është njëra prej shërbimeve të zgjeruara vetëm për komunat me shumicë serbe. Autoritetet lokale të këtyre komunave kanë përgjegjësi që të bëjnë promovimin dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe religjioze. Mistrria kompetente për të mbikëqyrë këtë kompetencë nuk ka të dhëna për shkallën e përmbushjes së komunave serbe. Komunat së bashku me policinë e Kosovës janë të obliguara që të sigurojnë mbrojtjen e objekteve të trashëgimisë kulturore serbe dhe të ndalohet çfarëdo lloj ndërtimi në perimetër prej 100 m.

### Regjistrimi dhe licencimi i bizneseve

Është shërbim që është deleguar nga PQ në komuna dhe që ka hasë në vështërsi të theksuara të funksionimit. Deri sa Ligji për Financat e Pushtetit Lokal ju mundëson komunave të inkasojnë te hyra nga taksat për lejen dhe ushtrimin e veprimtarisë afariste, Ligji për Tregti të Brendshme ju ndalon komunave të inkasojnë të hyra nga regjistrimi bizneseve. Kjo ka shkatuar probleme ligjore dhe funksionale.

## **Shërbimet e Transferuara**

Këto lloj shërbimesh ofrohen nga niveli qendror, por edhe mund të delegohen tek autoritetet lokale nëse komuna provon se mund t'iu shërbej qytetarëve me cilësi. LVL-ja ka përcaktuar gjashtë lloje të shërbimeve të cilat duhet ti delegohen komunave: *shërbimet kadastrale, regjistrimin civil, regjistrimin e votuesve, regjistrimin e bizneseve dhe licencimin e tyre, shpërndarjen e pagesave të ndihmës sociale dhe mbrojtjen e pyjeve*. Jo të gjitha këto kompetenca janë deleguar në komuna, disa prej tyre ka probleme për delegim, përderisa edhe kompetencat e deleguara po kanë probleme në funksionim. Qeveria e Kosovës mund t'iu delegojë të drejtën edhe për ofrimin e shërbimeve tjera nëse vlerësohet se komunat kanë kapacitete për ofrim të atyre shërbimeve. Kjo është një qasje fleksibile e delegimit të ofrimit të këtyre shërbimeve, çka do të thotë se nëse komunat nuk kanë sukses në ofrimin me cilësi të këtyre shërbimeve, mund t'iu merret kjo e drejtë.

## **Shërbimet e Shtesë**

Në disa komuna specifike me shumicë serbe, për shkak të natyrës politike, iu janë dhënë të drejtat për ofrimin e disa shërbimeve të cilat janë të drejta ekskluzive të nivelit qendror, si: ofrimi i shërbimeve dytësore shëndetësore, ofrimin e shërbimeve në nivelin universitar, mbrojtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore dhe religjioze serbe dhe pjesëmarrja në emërimin e komandantëve të policisë për komunitetin serb<sup>39</sup>. Këto shërbime shndërrohen në shërbime themelore apo vetanake dhe nuk mund të tërhiqen pa marrëveshje politike. Duke qenë se këto shërbime nuk janë thjesht administrative, komunat serbe ende nuk kanë mundësi që t'i zbatojnë plotësisht për shkak të mungesës së kapaciteteve dhe problemeve politike.

## **Kapacitetet e Komunave**

Për ofrimin e shërbimeve dhe funksionimin e sistemit të VQL, kërkohen kapacitete përkatëse të komunave. Për vlerësimin e kapaciteteve të komunave, MAPL ka zhvilluar dy hulumtime profesionale në vitin 2009 dhe 2011. Në bazë të hulumtimeve të bëra rezulton se kapacitetet njerëzore janë të nivelit të mesëm. Prej numrit të përgjithshëm të përgjigjeve në pyetësor – 6348, 615 ose 10% janë përgjigjur se kapacitetet e komunave qëndrojnë në nivelin e ulët, 1417 ose 22% prej tyre kanë vlerësuar se kapacitetet qëndrojnë në nivelin Themelor, 2664 ose 42% prej tyre kanë vlerësuar se kapacitetet qëndrojnë në nivelin e mesëm dhe 1652 ose 26% prej tyre kanë vlerësuar se kapacitetet e komunave janë në nivelin e lartë<sup>40</sup>.

---

<sup>39</sup> Kuvendi i Kosovës: “*Ligji për Vetëqeverisje Lokale, Prishtinë 2008*”, neni 20, 21, 22 dhe 23.

<sup>40</sup> MAPL: “*Raporti i vlerësimit të kapaciteteve në komuna*”, Prishtinë, 2011.

## **Performanca e Komunave në Ofrimin e Shërbimeve**

Është një proces i ndërlikuar dhe mjaftë profesional që vendet e ndryshme të botës e zbatojnë për të vlerësuar shkallën e përmbushjes së kërkesave të qytetarëve nga ana e PL. Në këtë pikëpamje përpiqemi t'i përgjigjemi në mënyrë sa më të saktë pyetjes se si e dimë ne se sistemi për VQL është funksional dhe qytetarët i marrin shërbimet në kohën e duhur dhe me cilësi? Funksionimi i një sistemi vlerësohet parimisht duke e matë atë se çfarë është dashur të prodhojë ai. Për matjen dhe vlerësimin e performancës së komunave në ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve, MAPL ka ndërtuar një sistem administrativ për këtë qëllim. Në botë ka lloje të ndryshme të sistemeve për menaxhimin e performancës së komunave (SMPK). Sistemet e MPK janë të bazuar kryesisht në standarde dhe tregues përkatës të matshëm, sipas metodës SMART.

SMPK në Kosovë është i ndërtuar prej 95 treguesve që korrespondojnë me arritjet e komunave për 15 fusha të shërbimeve prej gjithsej 28 fushave. Sistemi duke mos u bazuar në standarde, nuk matë cilësinë e shërbimeve, por vetëm sasinë e shërbimeve të ofruara. Se çfarë shërbimesh po ju ofron komuna qytetarëve, mund ta kuptojmë vetëm kur i krahasojmë rezultatet me vitet e mëparshme. Në bazë të krahasimit bëjmë vlerësimin relativ të ofrimit të shërbimeve. Në kuadër të SMPK bën pjesë komponenta më e rëndësishme e sistemit, shkalla e kënaqshmërisë së qytetarëve me shërbimet e ofruara nga komuna. MAPL në bashkëpunim me USAID dhe UNDP, zhvillojnë anketa me qytetarët për të matë shkallën e kënaqshmërisë së tyre me ofrimin e shërbimeve. Edhe kjo metodë përcillet me disa probleme të cilat në të ardhmen duhen përmirësuar në mënyrë që vlerësimi të jetë sa më i saktë. Në vazhdim mund të gjeni pasqyrën e rezultateve të vlerësimit të performancës së komunave në ofrimin e shërbimeve kryesore.

## **BASHKËPUNIMI NDËRKOMUNAL**

Bashkëpunimi ndërkomunal është e drejtë e komunave e garantuar me kushtetutë dhe rregulluar me ligj. Duke pas parasysh këtë fakt është nxjerrë Ligji për Bashkëpunim Ndërkomunal, me anë të cilit është krijuar baza ligjore për rregullimin e këtij procesi. Bashkëpunimi ndërkomunal përfshinë në vete edhe bashkëpunimin e komunave me komunitat e shteteve fqinj, institucionet dhe asociacionet e ndryshme ndërkombëtare.

### **Bashkëpunimi Ndërkomunal Vendor**

Me qëllim të ushtrimit të kompetencave të tyre, komunat kanë të drejtë të hyjnë në marrëdhënie bashkëpunimi ndërmjet tyre. Format e bashkëpunimit ndërkomunal mund të realizohen nëpërmjet: grupeve të përbashkëta punuese, organeve të përbashkëta administrative, institucioneve të përbashkëta publike, ndërmarrjeve të përbashkëta publike dhe partneriteteve të përbashkëta publiko - private. Me këto forma të bashkëpunimit është synuar të arrihen interesat e përbashkëta ekonomike lokale, ushtrimin e kompetencave vetanake ose të zgjeruara, rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit të burimeve njerëzore dhe financiare të tyre.

Ligji për Bashkëpunim Ndërkomunal, ka parapa një strukturë të përbashkët administrative (horizontale), me kompetenca që duhet t'i ushtrojë, me kryesues të organit të përbashkët administrativ, me seli të organit të përbashkët administrativ, me buxhet dhe kontabilitet, me mënyrë të financimit dhe me mënyrën e kontrollit dhe mbikëqyrjes. Edhe pse ky organ është menduar të jetë një strukturë horizontale, ndërmjet komunave, me përcaktimin e attributeve të tij, lehet mundësia e interpretimit të ndryshëm. Kjo është në përputhje me Nenin 9, pika 9.1.2 të Pakos së Ahtisarit dhe Nenit 29, pika 29.3 e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, ku thuhet se komunat mund të themelojnë një organ vendimmarrës të përbërë nga përfaqësuesit e emëruar nga Kuvendet e komunave pjesëmarrëse. E drejta e një organi përfaqësues që të merr vendime, është e drejtë ekzekutive, që është në kundërshtim me ligjet në fuqi. Në vend të kësaj komunat do të duhej të bashkëpunonin me të njëjtat struktura organizative ekzistuese, por me mbulim të shërbimeve reciproke për fushat përkatëse.

Bashkëpunimi ndër-komunal bëhet ndërmjet institucioneve të vetëqeverisjes lokale të Republikës së Kosovës në fushat që komunat e vlerësojnë të nevojshme. Fushat kryesore që mund të bashkëpunojnë janë: *planifikimi strategjik; planifikimi urban dhe rural, zhvillimi ekonomik lokal dhe rajonal, planifikimi hapësinor, zhvillimi i politikave të banimit,*

*transporti publik, zhvillimit dhe përparimi i shëndetësisë publike, përparimi i arsimit publik lokal, zhvillimi i infrastrukturës urbane etj.* Në përputhje me këtë qëllim MAPL, ka ndihmuar autoritetet lokale në themelimin e pesë (5) Agjencive të Zhvillimit Rajonal (AZHR), për promovimin e zhvillimit të integruar rajonal nëpërmjet krijimit të rajoneve ekonomike të Kosovës (Qendër, Lindje, Veri, Jug dhe Perëndim), të përkrahur nga Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian në Kosovë. Themelimi i këtyre agjencioneve zhvillimore rajonale ka ngritë nevojën e rregullimit të funksionimit të tyre, për shkak se statusi i tyre nuk është mirë i definuar. Funksionimi i tyre si OJQ i përjashton institucionet shtetërore nga përgjegjësia e financimit dhe e menaxhimit të tyre. AZHR – udhëheqë nga bordi, anëtarë të cilit janë kryetarët e komunave. Kryetari i bordit zgjedhet kryetari i njëres komunë për një mandat me rotacion. Për punën e tyre i përgjigjen bordit dhe Zyrës së Bashkimit Evropian. Kjo strukturë e përzier, qeveritare dhe joqeveritare, dhe koncepti i funksionimit sipas nivelit rajonal len hapësirë për korrigjime në të ardhmen. Zhvillimi i projekteve dhe realizimi i tyre financohet nga BE dhe MAPL, ku kjo e fundit merr pjesë me 5% të fondit të përgjithshëm në vit. BE dhe MAPL menaxhojnë fondet e veta në projekte të përbashkëta. Qëllimi kryesor është që të ndihmohet dhe promovohet një zhvillim i balancuar ekonomik ndërmjet komunave dhe komuniteteve në Kosovë. Një përvojë e ngjashme ekziston edhe në vendet e rajonit dhe në vendet e ish Bashkimit Sovjetik.

### Asociacioni i komunave

Komunat e Republikës së Kosovës kanë formuar një *asociacion të komunave të Kosovës* për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të tyre të përbashkëta. Asociacioni funksionon si OJQ dhe bashkërendon aktivitetet e ndryshme me interes të komunave. Anëtar të asociacionit janë të gjitha komunat e RK, që nuk është e domosdoshme. Në nivelin e organizimit të asociacionit të komunave nuk ka detyra vendimmarrëse, por vetëm ofrim të shërbimeve profesionale dhe teknike, nëpërmjet ngritjes së kapaciteteve, hulumtimeve profesionale për ushtrimin e kompetencave dhe rekomandimeve për politikat e komunave.

### **Bashkëpunimi Ndërkomunal Ndërkombëtar**

Me infrastrukturën ligjore është krijuar mundësia e bashkëpunimit ndërkomunal me komunat kufitare të vendeve që janë në kufi me Republikën e Kosovës. Kjo ka nxitë bashkëpunimin ndërkufitar të komunave me komunat e shteteve fqinj, me qëllim të promovimit të zhvillimit rajonal të vendeve përkatëse. Në bazë të Rregullativës të Komisionit (EC) No. 718/2007 të 12 Qershorit 2007 për zbatimin e Rregullativës së Këshillit (EC) no. 1085/2006 për themelimin e Instrumentit të Para Aderimit (IPA), Kosovës i jepet mundësia e qasjes dhe i shfrytëzimit të fondeve të Komponentës së Dytë (II) të Bashkëpunimit Ndërkufitar me të gjitha vendet fqinje. *Objektivat e përgjithshme*



të programeve të BNK janë që të promovojnë bashkëpunimin ndërmjet njerëzve, komuniteteve dhe institucioneve në zonat ndërkufitare dhe të promovojnë zhvillimin e qëndrueshëm, stabilitetin dhe prosperitetin e këtyre zonave në interes të përbashkët të banorëve të dy vendeve. Menaxhimi i programeve të BNK bëhet nëpërmjet modelit të menaxhimit të centralizuar. Kjo nënkupton se kontraktimi dhe pagesat për të gjithë projektet e BNK bëhen nga Delegacionet e Bashkimit Evropian në vendet respektive. Në të gjitha alokimet financiare, Kosova merrë pjesë me kontribut financiar 15% mbi vlerën e alokuar.

Komunat e Republikës së Kosovës kanë të drejtë në bashkëpunimin ndërkufitar me komunat dhe institucionet, përfshirë agjencitë Qeveritare të Republikës së Serbisë, brenda kompetencave të tyre, ashtu siç është përcaktuar në nenin 30 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokal. Forma e këtij bashkëpunimit është e ndërlidhur me asistencën financiare dhe teknike nga institucionet e Serbisë, përfshirë personelin e specializuar dhe mjetet në zbatimin e përgjegjësive komunale. Me këto të drejta, komunave të caktuara, u krijohet mundësia e pabarabartë në bashkëpunim ndërkombëtar. Bashkëpunimi komunal ndërkombëtar zhvillohet në bazë të procedurave të përcaktuara me ligj dhe komunat nuk kanë të drejtë të abstenojnë në ushtrimin e të gjitha kompetencave të tyre gjatë procesit të bashkëpunimit. MAPL ka të drejtë të mbikëqyrë ligjshmërinë e bashkëpunimit ndërkombëtar të komunave.

### **Marrëdhëniet Ndërmjet Qeverisë Lokale dhe Qendrore**

Sa do që të zhvillohet vetëqeverisja e pushtetit lokal, komunat kanë nevojë të ruajnë bashkëpunimin e tyre me nivelin qendror. Sa do që të delegohen kompetencat në pushtetin lokal, një pjesë e përgjegjësive mbetet në nivelin qendrorë. Qeveria qendrore është përgjegjëse për zhvillimet në nivel të vendit, ndërsa komunat janë përgjegjëse për zhvillimet në një pjesë të caktuar të vendit. Që këto dy nivele të jenë në funksion të njëra tjetrës, është e domosdoshme që të organizohet dhe të rregullohet bashkëpunimi ndërmjet tyre. Për zbatimin e politikave kombëtare në nivel lokal, qeveria harton ligje dhe akte tjera nënligjore, ndanë mjete të konsiderueshme buxhetore dhe burime njerëzore për të ndihmuar vetëqeverisjen lokale. Krahas kësaj, Qeveria ofron edhe mbikëqyrjen e zbatimit të politikave në PL. Mbikëqyrja organizohet për ta ndihmuar PL në ofrimin e shërbimeve të komunitetit në përputhje me politikat kombëtare dhe ligjet në fuqi.

Organizimi i ndërlidhjes së pushtetit qendror (PQ) me PL bëhet nëpërmjet ligjeve, planeve strategjike, të bashkëpunimit të drejtpërdrejt, ministri e linjës komunë. Bashkëpunimi i drejtpërdrejt ndërmjet komunës dhe qeverisë bëhet edhe kur MAPL

konstaton se kryetari i komunës ka shkel ligjet dhe kushtetutën e vendit dhe qeveria bën suspendimin e kryetarit.

Duke pas parasysh se Qeveria qendrore nuk mund të merret drejtpërdrejt me ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve, ajo u delegon komunave një numër të kompetencave, për zbatimin e të cilave komunat kanë kapacitet ekzistuese ose që mund të ndërtohen dhe zhvillohen. Me procesin e decentralizimit të pushtetit, komunat fitojnë tre lloje të kompetencave: *kompetencat vetanake; kompetencat e deleguara dhe kompetencat e zgjeruara*. Kompetencat vetanake komunat i fitojnë me aktin e themelimit të komunave, kompetencat e deleguara janë të drejta që i delegohen komunës nga PQ dhe nëse komuna nuk ka kapacitete për ushtrimin e tyre, ato prap mund të tërhiqen dhe kompetencat e zgjeruara janë të drejta të shtuara vetëm për disa komuna me kërkesa specifike politike, në fushën e arsimit, kulturës dhe shëndetësisë. Për ushtrimin e këtyre kompetencave të nivelit qëndror, komunat serbe kanë nevojë për bashkëpunim të ngushtë me Qeverinë. Edhe pse kapacitetet për ofrimin e këtyre shërbimeve nga PL janë të kufizuara, Qeveria është përpjekur të krijoj një sistem funksional për integrimin politik të komuniteteve jo shumicë (shmangien e krijimit të sistemit paralel) dhe në anën tjetër plotësimin e kërkesave praktike për ofrimin e shërbimeve qytetarëve.

Qeveria duke dashur që të qëndrojë pranë zhvillimeve në rrafshin lokal dhe t'iu ndihmojë komunave, ka krijuar struktura administrative dhe teknike të dekoncetrura për dy e ma shume komuna. Edhe pse ligjërisht nuk ka struktura rajonale ato defakto ekzistojnë dhe funksionojnë nën përkrahjen e PQ dhe institucioneve ndërkombëtare. Për zhvillimin ekonomik lokal, janë themeluar 5 agjencione rajonale të zhvillimit nën përkrahjen e KE, MASHT ka themeluar 7 zyra rajonale të inspektimit, ngjashëm janë themeluar Qendrat Rajonale për Trashëgimi Kulturore, Kompanitë Rajonale për shërbime komunale etj. Këto struktura kanë sa i kanë ndihmuar komunat, po aq i kanë penguar në ushtrimin e kompetencave të tyre.

# MBIKËQYRJA DHE KONTROLLI

## *Kuptimi i mbikëqyrjes dhe i kontrollit*

Mekanizmi i kontrollit të organeve të administratës shtetërore është pjesë e kompetencave e cila realizohet në bazë të autorizimeve ligjore. Në kuptimin përmbajtjesor, me kontroll kuptohet veprimtaria e vazhdueshme e mbikëqyrjes që subjektet juridikisht të autorizuar e bëjnë lidhur me sjelljen e organeve të administratës, mënyrën e ushtrimit të autorizimeve, mënyrën e nxjerrjes së akteve dhe shkallën e zbatimit të legjislacionit, si dhe masave të cilat i ndërmarrin në raport me ushtrimin e përgjegjësisë. Ndërkaq, qëllimi i kontrollit është “të pamundësohet nxjerrja, përkatësisht aplikimi i atij akti të përgjithshëm normativ nënligjor që do t’i kundërviej kushtetutës apo ligjit. Për këtë shkak edhe me sanksionet, që sistemet e veçanta juridike i parashohin, tentohet që nga rendi juridik të shmangen ato akte të përgjithshme normative nënligjore dispozitat e të cilave nuk janë në pajtim me parimet e shprehura në kushtetutë, përkatësisht me ligjet”<sup>41</sup>. Edhe pse termi kontroll dhe mbikëqyrje, mund të kuptohen si të njëjta, ato kanë kuptime dhe veprime të ndryshme. Sistemi i jonë i kontrollit më tepër është i orientuar në mbikëqyrje se sa në kontroll.

Në Republikën e Kosovës, sistemi i mbikëqyrjes së organeve të pushtetit lokal është rregulluar me Kushtetutë, me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale dhe me ligje të tjera sektoriale. Ky sistem është kufizuar më tepër në mundësinë e ndërhyrjes këshilluese dhe rekomanduese me rastin e ushtrimit të kompetencave nga organet e njësisive të vetëqeverisjes lokale dhe është ndërtuar si pjesë e marrëdhënieve në mes të nivelit qendror dhe atij lokal.

Komunat gëzojnë shkallë të lartë të vetëqeverisjes lokale, inkurajojnë dhe sigurojnë pjesëmarrje aktive të të gjithë qytetarëve në procesin e vendimmarrjes së organeve komunale<sup>42</sup>. Vetëqeverisja lokale është sistem autonom i qeverisjes, përmes së cilës komunave u atribuohet drejtimi politik, juridik, administrativ dhe financiar i tyre. Ky sistem promovon sjelljen demokratike, transparencën dhe llogaridhënien si dhe garanton një sistem kontrolli të ndërsjellë në nivel komunal për të parandaluar veprimet e kundërligjshme. Kësisoj, komunat janë të obliguara që ushtrimin e veprimtarisë ta zhvillojnë sipas Kushtetutës, ligjeve, normave të cilat i nxjerrin vetë, norma të cilat mund të kenë të njëjtin ndikim e efikasitet si të normave shtetërore, edhe pse të varura nga këto të fundit.

---

<sup>41</sup> Pollozhani, Bajram & Dobjani, Ermir & Stavileci, Esat & Salihu, Lazim: “*E drejta administrative – aspekte krahasuese*”, 2010, fq. 49.

<sup>42</sup>Kuvendi i Kosovës: “*Kushtetuta e Republikës së Kosovës*”, neni 124.

## ***Llojet e mbikëqyrjes dhe kontrollit***

Duke marrë parasysh kompetencat e shumta vetanake të cilat janë paraparë me ligj, komunat janë të obliguara për respektimin e rendit juridik dhe të parimeve të përgjithshme të qeverisjes lokale. Rishikimi administrativ i akteve të komunave nga autoritetet qendrore në fushën e kompetencave të tyre është paraparë si mundësi e mirë për kufizimin e shkeljeve ligjore gjatë punës së organeve komunale. Pavarësisht autonomisë së komunave në kryerjen e veprimtarive të tyre, legjislacioni ka përcaktuar një shkallë të varësisë në marrëdhënie me organet qendrore. Në këtë segment, parashikimi me ligj i funksionit me natyrë mbikëqyrëse të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) dhe Ministrive të tjera të linjës ndaj komunave, është me rëndësi të veçantë në parandalimin e shkeljes së ligjit nga ana e komunave. Kjo përkon me mbikëqyrjen e respektimit të ligjshmërisë, të parashikuar me ligj dhe të vendosur vetëm për arsye të rëndësishme publike<sup>43</sup>.

Kuptimi i mbikëqyrjes dhe kontrollit të komunave në Kosovë përcaktohet në dy rrafshë:

- Kontrolli i brendshëm; dhe
- Kontrolli i jashtëm.

Në kuadër të mbikëqyrjes, duhet përmendur edhe *mbikëqyrjen shoqërore*, e cila realizohet përmes formave të ndryshme të demokracisë së drejtpërdrejtë.

### **Mbikëqyrja dhe Kontrolli i Brendshëm**

Mbikëqyrja dhe kontrolli i brendshëm në komunë nënkupton të drejtën e organeve të komunës të autorizuar ligjërisht, për sigurimin e respektimit të ligjshmërisë dhe kushtetutshmërisë nga organet e nivelit më të ulët përbrenda komunës. Duke marrë parasysh ndarjen strukturore Kuvend/Ekzekutiv përbrenda komunës, ekzistojnë edhe përgjegjësitë për kontrollimin e punës së këtyre organeve, duke marrë parasysh natyrën e fushëveprimit të tyre. Korniza ligjore ka përcaktuar mundësitë e kontrollit të organeve komunale në dy mënyra:

- kontrolli që kryen Kuvendi i Komunës ndaj ekzekutivit në tërësi dhe
- kontrolli që bënë kryetari i komunës në raport me drejtoritë komunale

---

<sup>43</sup>Republika e Kosovës, MAPL: “Raport i funksionimit të komunave, janar-dhjetor 2012”, Prishtinë 2013, fq. 4.

### **Kontrolli i kuvendit ndaj ekzekutivit**

Megjithëse nga pikëpamja e kontrollit, nuk janë paraparë dispozita specifike të cilat normojnë formën e kontrollit (kuvend-ekzekutiv), kjo çështje mund të kuptohet në bazë të hierarkisë së përcaktuar me ligj. Sipas LVL-së, Kuvendi i Komunës është përcaktuar të jetë organi më i lartë në komunë<sup>44</sup>, dhe njëkohësisht organ mbikëqyrës në nivelin lokal, kompetent për të siguruar ofrimin e shërbimeve nga ekzekutivi në pajtim me legjislacionin në fuqi. Në anën tjetër, kryetari i komunës është përgjegjës të zbatoj vendimet e Kuvendit të Komunës, si dhe të raportoj në këtë organ për situatën ekonomiko-financiare të komunës dhe për zbatimin e planeve investuese të komunës, së paku njëherë në gjashtë muaj apo kurdoherë që kërkohet nga kuvendi i Komunës<sup>45</sup>. Kjo sferë më tepër plotësohet përmes akteve nënligjore komunale, përkatësisht me Rregulloren e Punës së Kuvendit të Komunës, e cila “parasheh menaxhimin dhe kontrollin efektiv, përfshirë mbikëqyrjen financiare, të administratës komunale. Rregullorja shtjellon edhe çështjet teknike që ngrihen gjatë seancave plenare dhe takimeve të komiteteve të kuvendit”<sup>46</sup>.

Në praktikë është parë se kryetarët e komunave paraqesin me shkrim raportet në kuvendet e komunave, miratimi i të cilave është çështje e brendshme e komunave. Edhe pse Ligji Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësiive “nuk ka përcaktuar votimin (miratimin) e raporteve financiare nga Kuvendet e Komunave, megjithatë miratimi i këtyre raporteve është praktikë e shumicës së komunave”<sup>47</sup>.

Forma të tjera të raportimit janë ato verbale, ku anëtarët e kuvendit i parashtrojnë pyetje të drejtpërdrejta apo me shkrim ekzekutivit të komunës. Praktika të tilla, janë parë si mundësi e mirë e llogaridhënies së ekzekutivit para kuvendit të komunës dhe ofrimit të përgjigjeve për shumë çështje. Veçanërisht, disa kuvende të komunave i japin prioritet parashtrimit të pyetjeve të drejtpërdrejta ekzekutivit të komunës, duke rregulluar këtë segment me prioritet në rendin e ditës”<sup>48</sup>.

---

<sup>44</sup>Po aty, neni 35, parag. 1.

<sup>45</sup>Po aty, neni 58, pika d), j).

<sup>46</sup> Pollozhani, Bajram & Dobjani, Ermir & Stavileci, Esat & Salihu, Lazim: “*E drejta administrative – aspekte krahasuese*”, 2010, fq. 217.

<sup>47</sup> MAPL: “*Raporti i funksionimit të kuvendeve të komunave të Republikës së Kosovës*”, janar-qershor 2013”, DLMK, 2013, Prishtinë, fq. 13.

<sup>48</sup>MAPL: “*Raporti i funksionimit të kuvendeve të komunave të Republikës së Kosovës*”, janar-qershor 2013”, DLMK, 2013, Prishtinë, fq. 12.

## **Kontrolli i hartimit të politikave komunale**

Kuvendi i komunës dhe kryetari kanë të drejtë të miratojnë akte dhe të ndërmarrin masa për zbatimin e tyre brenda fushës së kompetencave të tyre<sup>49</sup>. Shumica e propozimeve të cilat paraqiten për diskutim dhe miratim në mbledhjet e kuvendit të komunës, janë propozime të ekzekutivit të komunës. Ndërkaq, kuvendi me Planin e Punës, përcakton prioritetet në hartimin e politikave të nivelit lokal. Për të mundësuar kontrollin e kuvendit të komunës ndaj propozim akteve të ekzekutivit, me ligj është paraparë që 7 ditë para mbajtjes së mbledhjes së kuvendit të gjithë anëtarët e kuvendit të komunës të njoftohen me shkrim.

Nga praktika e deritanishme është vërejtur përfshirja e propozimeve të kryetarëve të komunave në rendin e ditës, pa kaluar nëpër komitetet e obligueshme dhe pa materialin përcjellës për çështjen e caktuar. Në anën tjetër, për përcaktimin e agjendës së punës së kuvendit praktika “kërkon bashkëpunimin në mes të dy organeve - ekzekutivit dhe Kuvendit, e gjithashtu me komitetet e obligueshme, komitetet e tjera dhe aty ku janë themeluar komitetet konsultative. Në rastet kur ky koordinim ka munguar, mbledhjet e kuvendit janë zhvilluar me vështërsi, mosvotim të një pike të caktuar apo edhe lëshimit të mbledhjes nga kuvendarët<sup>50</sup>.

Zyrtarët ligjor të komunave marrin pjesë në procesin hartimit e të draft-akteve komunale dhe mund të luajnë një rol më të theksuar në mbikëqyrjen e zbatimit të ligjshmërisë gjatë miratimit të tyre në kuvend e që aktualisht nuk janë të përfshirë. Konsolidimi i kuvendeve të komunave me personelin mbështetës ligjor, është e domosdoshme për evitimin e jo-ligjshmërisë me rastin e nxjerrjes së akteve juridike nënligjore komunale.

Zyrat e themeluara ligjore në komuna “nuk kanë strukturë të qartë hierarkike, derisa numri i personelit ndryshon nga një deri në katër zyrtarë ligjorë.

## **Kufizimet ligjore në procesin e mbikëqyrjes**

Problemi i ushtrimit të rolit mbikëqyrës të kuvendit të komunës ka ardhur si pasojë e ndryshimit të disa dispozitave të caktuara ligjore. Në një dispozitë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale theksohet që “Kuvendi i Komunës konsiderohet jo-funksional nëse nuk miraton buxhetin sipas afatit të paraparë me ligjin përkatës”<sup>51</sup>, ndërsa projekt-buxheti komunal propozohet nga kryetari i komunës dhe jo gjithëherë mund të përmbajë kushtet dhe kërkesat e anëtarëve të kuvendit të komunës. Sipas kësaj dispozite, Kuvendi

---

<sup>49</sup>Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, neni 11.

<sup>50</sup> MAPL: “Raporti I funksionimit të kuvendeve të komunave të Republikës së Kosovës, janar-qershor 2013”, DLMK, 2013, Prishtinë, fq. 12.

<sup>51</sup>Kuvendi i Kosovës: “*Ligjit Nr. 03/L-040 për vetëqeverisje lokale*”, neni 50.2

i Komunës është i “detyruar” për të miratuar propozim-buxhetin e propozuar nga kryetari i komunës, edhe në rast se nuk përmban propozimet që burojnë nga kuvendi i komunës. Në anën tjetër, për kryetarin e komunës, mosmiratimi i projekt-buxhetit nuk përbënë ndonjë shqetësim të veçantë, për arsye se procedurat e mëtutjeshme rregullohen sipas dispozitave të nenit 62 të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi. Këto dispozita kryetarin e komunës e zhveshin nga përgjegjësia e projekt-buxhetit komunal, duke i bartur këtë të drejtë ministrit të financave dhe administratorit financiar komunal të emëruar nga ministri.

### **Shfuqizimi i akteve të paligjshme komunale**

Shtrohet pyetja se cili organ brenda komunës ka të drejtën e shfuqizimit të një akti komunal kundërligjor. Kjo çështje në legjislacionin tonë nuk është qartësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë. Sipas ligjit, kryetari i komunës në rastet e përballjes me akte joligjore të miratuara në Kuvendin e komunës, mund të ndërmarrë dy hapa për të evituar joligjshmërinë:

- a) Përmes kërkesës drejtuar kuvendit të komunës që të shqyrtojë një akt komunal para hyrjes në fuqi, kur konsideron se akti cenon legjislacionin në zbatim dhe/apo interesin e komuniteteve.
- b) Përmes mundësisë së shqyrtimit të ligjshmërisë nga organi mbikëqyrës, me anë të së cilit merr përgjigje lidhur me mundësinë e aplikimit të një akti të përgjithshëm normativ nënligjor.

Një dispozitë e veçantë në ligjin për vetëqeverisje lokale, me të cilën kryetari i komunës do të obligohet për moszbatimin e akteve të kundërligjshme të nxjerra nga kuvendi i komunës dhe njëkohësisht të parashtronte kërkesën për shqyrtimin e tyre nga organi mbikëqyrës, do ta ta forconte rolin e kontrollit në parandalimin e zbatimit të akteve të kundërligjshme.

### **Kontrolli i administratës**

E drejta e kryetarit të komunës për të emëruar dhe shkarkuar drejtorët e komunës, e bën përgjegjës drejtorin për të raportuar. Kryetari e kontrollon punën e drejtorit dhe drejtoratit në përgjithësi edhe me rastin e shqyrtimit të ankesave të personave fizikë dhe juridik për shkeljet eventuale lëndore. Për të vendosur për çështjet administrative në shkallë të parë kompetenca lëndore u përket organeve komunale të administratës, në qoftë se vendosja e këtyre çështjeve nuk u është kaluar me ligj njësisive tjera territoriale

brenda territorit të Kosovës, apo në qoftë se me ligj nuk është caktuar kompetenca e organeve tjera”<sup>52</sup>. Pra, kjo dispozitë nënkupton njëshkallshmërinë për çështje administrative në nivelin lokal, mirëpo procedura ankimore është mjaft e detajuar. “Personat fizikë dhe juridikë kanë të drejtë të kërkojnë revokimin, shfuqizimin ose ndryshimin e aktit administrativ në përputhje me rregullat e vendosura nga ky Ligj për ankimin administrative”. Sipas këtyre rregullave, kjo e drejtë mund të ushtrohet në dy mënyra:

- a) nëpërmjet kërkesës për rishqyrtim drejtuar nëpunësit përgjegjës për aktin, në rastin konkret Drejtoratit përkatës të komunës dhe
- b) nëpërmjet ankimit drejtuar organit më të lartë, përkatësisht Kryetarit të Komunës.

Nga ajo që u tha më lartë, organi i cili në shkallë të parë vendos për ankesën e personave fizik dhe juridik është kryetari i komunës. Në rast se pala nuk merr përgjigje konkrete, merr përgjigje negative, i refuzohet ankesa ose çfarëdo përgjigje tjetër në kundërshtim me të drejtën që pala pretendon, për të vendosur lidhur me këtë ankesë, në shkallë të dytë janë përgjegjëse autoritetet qendrore (procedura nga poshtë/lartë). Në praktikë, janë shënuar raste kur personat e caktuar fizik apo juridik janë ankuar ndaj vendimeve administrative të Komunave. Në këtë kontekst, lëndët të cilat janë adresuar në MAPL, varësisht nga konstatimi i kompetencës ose janë dhënë përgjigjet nga kjo e fundit, ose janë drejtuar në autoritetin përgjegjës për shqyrtim.

## **Inspektimi**

Sic dihet, një pjesë e shërbimeve publike ofrohen nga autoritetet qendrore ndërsa një pjesë (më shumë) nga ato lokale. Komuna bën inspektimin e ofrimit të shërbimeve për disa shërbime si: inspektimi i tregut, inspektimi i ndërtimit, inspektimi fitosanitar etj. me qëllim të mbrojtjes së ligjshmërisë gjatë punës në këto veprimtari. Me centralizimin e disa kompetencave janë centralizuar edhe shërbimet e inspektimit. Edhe institucionet qendrore i kanë të organizuar shërbimet e veta të inspektimit, si: inspektimin e punës, të mjedisit, të arsimit të shëndetësisë etj. Disa nga shërbimet të parapara në kompetencë vetanake të komunave sic janë: shërbimet e ujësjellësit dhe kanalizimit, shërbimi i zjarrëfikësve, deponite regjionale të mbeturinave, janë shërbime të cilat ofrohen nga ndërmarrjet publike, agjencione, apo njësi të cilat në përgjithësi menaxhohen nga qeveria qendrore.

---

<sup>52</sup> Ligji Nr. 02/L-028 për Procedurën Administrative, neni 13.2.



## **Auditi i brendshëm**

Auditi i shpenzimit të parasë publike është obligim i secilit institucion publik. Në bazë të raporteve për vlerësimin e kapaciteteve (2009 dhe 2011) është vlerësuar se komunat i kanë të ndërtuara kapacitetet për ushtrimin e kontrollit të brendshëm të financave në shkallën 77%, që do të thotë se 23% e komunave ende nuk e kanë mirë të organizuar auditin e brendshëm. Ndërkaq sa i përket procesit të kontrollit të brendshëm dhe kapaciteteve për zbatim të ligjeve dhe akteve tjera nënligjore të nxjerra nga Thesari, të dhënat tregojnë se 19 e të anketuarve mendojnë se procesi i kontrollit të brendshëm është i dobët ose i pjesshëm dhe përdorimi i fondeve publike është jo adekuat, ndërsa 82% e të anketuarve mendojnë se në komuna bëhet zbatimi i rregullt i kontrollit të brendshëm në përputhje të plotë me procedurat e caktuara nga MF dhe se fondet publike shfrytëzohen sipas planit<sup>53</sup>.

Ligji për vetëqeverisje lokale ka obliguar komunat për themelimin e dy komiteteve të përhershme (KPF dhe KK) si mekanizma për shqyrtimin e të gjitha politikave komunale, propozimeve dhe dhënien e rekomandimeve Kuvendit të Komunës. Roli i tyre shprehet në diskutimin paraprak të të gjitha çështjeve të cilat parashikohet të diskutohen në Kuvendin e Komunës, prandaj edhe shihet si mekanizëm parandalues<sup>54</sup>.

## **Mbikëqyrja e Komunave nga Autoritetet Qendrore**

Mundësia e mbikëqyrjes së organeve të vetëqeverisjes lokale nga autoriteti mbikëqyrës është çështje e ngritur edhe në nivel kushtetues. Edhe pse komunat gëzojnë shkallë të lartë të vetëqeverisjes lokale, autoritetet qendrore kanë në kompetencë mbikëqyrjen dhe kontrollin e tyre me qëllim të sigurimit të ligjshmërisë së akteve komunale. Me kornizën ligjore në zbatim janë përcaktuar mekanizmat e rishikimit administrativ dhe të mbikëqyrjes së zbatimit të ligjshmërisë nga niveli qendror. Mbikëqyrja e punës së organeve komunale duhet të jetë në pajtim me ligjin dhe KEVL e që nuk lejohet të cenohet autonomia e vetëqeverisjes lokale gjatë ushtrimit të mbikëqyrjes.

“Cdo kontroll administrativ i veprimtarisë së autoriteteve lokale duhet të synojë vetëm sigurimin e respektimit të ligjit dhe parimeve kushtetuese”<sup>55</sup>. Për më tepër, Karta vendos që çfarëdo mbikëqyrje nga ana e autoriteteve të nivelit qendror duhet të bëhet në proporcion me rëndësinë e detyrave që janë duke u mbikëqyrur, derisa komunat do ta kenë të drejtën e shfrytëzimit të një mjeti juridik që të sigurojnë ushtrimin e lirë të kompetencave të tyre.

---

<sup>53</sup> MAPL: “Raporti i Vlerësimit të Kapaciteteve në Komuna”, Prishtinë 2011, fq. 43.


<sup>54</sup> Kuvendi i Kosovës: “Ligji Nr. 03/L-040 për vetëqeverisje lokale”, neni 51.

<sup>55</sup> Këshilli i Evropës: “Karta Evropiane për Vetëqeverisje Lokale”, Strasburg, Shkurt, 1991, parag. 2, neni 8.

## Monitorimi i komunave nga MAPL

Me LVL janë përcaktuar normat e mbikëqyrjes mbi punën e organeve të komunës në kryerjen e autorizimeve ligjore. Me këtë ligj janë përcaktuar objektivat dhe parimet e shqyrtimit administrativ, të përqendruara në forcimin e aftësisë së organeve të vetëqeverisjes lokale në përmbushjen e përgjegjësisë të tyre nëpërmjet këshillimit dhe përkrahjes në mënyrë që të sigurohet. Këto parime qëndrojnë në përputhje me frymën e KEVL, e cila ndër të tjera proklamon që MAPL është institucioni përgjegjës për mbikëqyrjen e kompetencave komunale për të cilat ligji nuk i ka përcaktuar detyrimin ligjor për mbikëqyrje një organi tjetër<sup>56</sup>. Varësisht nga veprimtaria që zhvillohet në nivelin lokal, kompetencat e mbikëqyrjes i ushtron ministria përgjegjëse për atë fushë dhe MAPL e ka rolin bashkërendues në gjithë këtë proces. Ajo është hallkë themelore e cila mundëson procesin e vlerësimit të ligjshmërisë së akteve komunale.

MAPL ka ndërtuar një sistem të avancuar të monitorimit, i mbështetur në dy mënyra kryesore: *përmes monitorimit me pjesëmarrje të drejtpërdrejtë në komuna* dhe *përmes monitorimit elektronik i cili realizohet në disa forma të ndryshme*.



**Fig. 1.** Skema e sistemit të monitorimit të komunave

Metodat dhe mjetet e monitorimit të komunave kanë mundësuar grumbullimin e informatave të sakta dhe të mjaftueshme për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjshmërisë dhe nuk janë shënuar raste të ndërhyrjes në autonominë e komunës gjatë procesit të monitorimit.

<sup>56</sup> MAPL: “Udhërrëfyes për Sistemin e Monitorimit dhe të Mbikëqyrjes së Komunave”, Prill, 2012, fq. 7.

## **Monitorimi on-line i komunave**

Duke marrë parasysh përparësitë që ofron fusha e teknologjisë informative dhe me qëllim të uljes së kostos financiare, MAPL e ka bërë instalimin e një programi të vecantë për të mundësuar mbikëqyrjen nga distanca nëpërmjet teleprezencës. Kjo është bërë me qëllim të avancimit të sistemit të monitorimit dhe komunikimit me Komunat e Republikës së Kosovës. Komponentë e kësaj ndërmarrje teknologjike për reformimin e sistemit të mbikëqyrjes dhe të përkrahjes së komunave në ofrimin e shërbimeve, është realizuar projekti “Softueri për Qendrat Për Shërbim të Qytetarëve (SQSHQ) dhe integrimi i tyre me Ueb faqet Komunale, me portalin Ministror dhe atë Qeveritar”.

Projekti i parë SQSHQ ofron mundësinë që të monitorohet efikasiteti i organeve të administratës, në lidhje me ofrimin e shërbimeve administrative, ndërsa projekti i dytë përmes teletrezencave i mundëson MAPL-së dhe të përcjellë punën e kuvendeve komunale me një shpejtësi reale dhe me një cmim shumë të ulët financiar<sup>57</sup>. Programi SQSHQ me portalin Ministror dhe atë Qeveritar” ka krijuar sistemin elektronik për menaxhimin e shkresave administrative në komunë. Me këtë siste lehtësohet puna e kontrollit të brendshëm të lëvizjes së shkresave dhe e mbikëqyrjes nga MAPL për efektivitetin e komunës në ofrimin e shërbimit ndaj qytetarëve.

Përdorimi i softuerit ka ndikuar në rritjen e cilësisë së shërbimeve, efikasitetit të menaxhimit, besueshmërisë ndaj qytetarëve, gjenerimin e treguesve të performancës, transformimin e shërbimeve (për qytetarët me aftësi të kufizuara), pjesëmarrjes së qytetarëve gjatë vendimmarrjes, bashkëpunimit ndërkomunal, pa patur nevojë për prezencë fizike në komunë. Kjo ka mundësuar zhvillimin e platformës për komunikimin e zyrave për shërbim të qytetarëve me portalin ministror dhe qeveritar, si dhe unifikimin e punës së drejtorateve brenda komunës dhe shëmangjen e punëve të dyfishta. Ndërsa, libri unik i protokollit ka shërbyer si platformë integruese e të gjitha aktiviteteve të ministrive të linjës që ushtrojnë aktivitete në komunë, në kuptimin e kërkesave të qytetarit, përgjigjeve etj. Lidhur me këtë, qytetarët kanë mundësi që të bëjnë kërkesat e tyre online, por edhe në rastet kur ata aplikojnë për kërkesa në Komuna, ata i adresojnë kërkesat e tyre vetëm në zyrën për shërbim të qytetarëve. Nëpërmjet sistemit online ata kanë mundësi të shohin nga shtëpitë e tyre deri në çfarë faze ka arritur trajtimi i kërkesës së tyre. Po asht MAPL është e gatshme të prodhojë raporte në çdo kohë në lidhje me numrin e zgjidhjes së kërkesave të qytetarëve dhe të vlerësojë saktë efikasitetin e administratës komunale në lidhje me respektimin e afateve ligjore<sup>58</sup>.

Për të mundësuar procesin e shqyrtimit administrativ dhe për të evituar joligjshmërinë, sipas Ligjit për vetëqeverisje Lokale është përcaktuar që “aktet e përgjithshme të

---

<sup>57</sup> MAPL: “Udhërrëfyes për Sistemin e Monitorimit dhe të Mbikëqyrjes së Komunave”, Prill, 2012, fq. 13.

<sup>58</sup> MAPL: “Udhërrëfyes për Sistemin e Monitorimit dhe të Mbikëqyrjes së Komunave”, Prill, 2012, fq. 13.

Kuvendit të Komunës si dhe vendimet i nënshtrohen shqyrtimit të detyrueshëm të ligjshmërisë. Komunitat janë të obliguara t'i dërgojnë aktet tek autoriteti mbikëqyrës brenda 7 ditësh nga dita e nxjerrjes së tyre<sup>59</sup>. Ndërsa, "autoriteti mbikëqyrës obligohet që të japë mendimin e tij për ligjshmërinë e çdo akti të regjistruar, brenda 15 ditësh nga pranimi i tij, në pajtim me procedurat e përmendura më lartë.

### **Komisionet ndërministrorë**

Për të forcuar efikasitetin e mbikëqyrjes Qeveria e Republikës së Kosovës ka nxjerrë Vendimin me Nr. 2/119, datë 07.04.2010 për formimin e komisioneve për vlerësimin e ligjshmërisë së akteve të komunave, për kompetencat vetanake, të deleguara dhe të zgjeruara. Komisionet përbëhen prej 3 anëtarëve, përbërja e të cilëve është: dy zyrtarë të ministrive të linjës dhe një zyrtar nga MAPL. Rastet kur komunitat nxjerrin akte të kundërligjshme janë shumë të shpeshta. Përmes monitorimit të drejtpërdrejtë të mbledhjeve të kuvendeve të komunave, evidentohen aktet të cilat miratohen në Kuvendet e Komunave. Aktet të cilat janë në kompetencë të autoriteteve të tjera të nivelit qendror, MAPL i shqyrton nga aspekti ligjor. Në anën tjetër, aktet e tjera si rregull i dërgohen ministritve kompetente, përkatësisht komisioneve ndërministrorë për të shqyrtuar ligjshmërinë e tyre.

### **Efikasiteti i organit mbikëqyrës**

Duke marrë parasysh se kuvendet e komunave nxjerrin akte nënligjore që rregullojnë fusha të ndryshme të marrëdhënieve juridike, siç janë: miratimin e planeve rregulluese urbane, akteve nga fusha e mjedisit, vendimeve lidhur me shfrytëzimin e pronës së paluajtshme, vendimeve për emërtimin e rrugëve, sferës së shërbimeve publike, akteve të karakterit financiar siç janë Rregulloret për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale, rishikimin buxhetor, akte të cilat promovojnë zhvillimin ekonomik të Komunave, për këtë arsye edhe shkeljet ndodhin më së shumti në të tilla raste. Efikasiteti i MAPL-së dhe komisioneve ndërministrorë në vlerësimin e ligjshmërisë së akteve, është paraqitur në skemën në vijim, vetëm si shembull në periudhën janar-qershor 2013.

Për rastet të cilat nuk janë harmonizuar sipas rekomandimeve të organit mbikëqyrës, MAPL ka realizuar takime të drejtpërdrejta me komunitat dhe është arritur përparim. MAPL ka përdorur metodën e konsultimit para dërgimit të rastit në gjykatë.

---

<sup>59</sup>Ligji Nr. 03/L-040 për vetëqeverisje lokale, neni 81.

# SHTOJCA

## **Shtojcë 1: Rregulloret e UNMIK 1999/2007**

- [Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 1999/14](#) Për Emërimin e Administratorëve Rajonalë dhe Komunalë;
- [Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2000/43](#) Mbi Numrin, Emrat dhe Kufijtë e Komunave;
- Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2000/45 Mbi Vetëqeverisjen e Komunave të Kosovës;
- Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2002/11 Mbi Zgjedhjet Komunale në Kosovë;
- [Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2003/11](#) Për Ndryshimin e [Rregullores Nr. 1999/14](#) Për Emërimin e Administratorëve Rajonalë dhe Komunalë;
- [Urdhëresa administrative Nr. 2005/11](#) 22 korrik 2005 Për pilot projektet;
- Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2006/54 Për Ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2000/45 Mbi Vetëqeverisjen e Komunave në Kosovë;
- Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2006/55 Për Ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2002/11 Mbi Zgjedhjet Lokale në Kosovë;
- Rregullorja e UNMIK-ut 2007/27 Mbi Zgjedhjet Lokale në Kosovë dhe Rregullorja e UNMIK-ut 2007/30 Për Ndryshimin e Rregullores Nr. 2000/45 Për Vetëqeverisjen e Komunave të Kosovës.

## **Shtojcë 2: Ligjet e sponsoruara nga MAPL**

- Ligji për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040
- Ligji për Financat e Pushtetit Lokale Nr. 03/L-049
- Ligji për Kufijtë Administrativ Nr. 03/L-041
- Ligji për Zgjedhjet Lokale Nr. 03/L-072
- Ligji për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Prones së Paluajtshme të Komunës Nr. 04/L-144
- Ligji për Bashkëpunim Nder-komunal Nr. 04/L-010

## **Shtojcë 3: Kompetencat Vetanake**

- **Zhvillimi ekonomik lokal:**
  - Ligji për Zonat Ekonomike Nr. 04/L-159;
  - Ligji Nr. 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L087 për Ndërmarrjet Publike
- **Turizmi:**
  - Ligji për turizëm Nr. 04/L-176;
  - Ligji për Trashëgimin Kulturor Nr. 02/L-88
- **Planifikimi Urban dhe Rural:**
  - Ligji për Planifikim Hapësinor Nr. 03/L-106
- **Përgjigje ndaj rasteve emergjente lokale:**

- *Ligji për Zjarrëfikje dhe Shpetim Nr. 04/L049;*
- *Ligji për Mbrojtjen nga Zjarri Nr. 04/L-012;*
- *Ligji për Mbrojtjen nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera Nr. 04/L-027.*
- **Ofrimi i arsimit publik parashkollor, fillor dhe te mesëm, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e institucioneve edukative, punësimin, pagesën e rrogave dhe trajnimin e instruktoreve dhe administratorëve të arsimit:**
  - *Ligji për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-032;*
  - *Ligji për Arsimin dhe Aftësimin për të Rritur në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-143.*
  - *Ligji për Arsimin në Komuna Nr. 03/L-068;*
- **Ofrimi i shërbimeve familjare dhe shërbimeve të tjera të mirëqenies sociale, siç është përkujdesin fëmijor, përkujdesin për të moshuarit, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e këtyre qendrave përkujdesëse, punësimin, pagesën e rrogave dhe trajnimin e profesionisteve të mirëqenies sociale:**
  - *Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare Nr. 04/L-081*
- **Banimi publik:**
  - *Ligji për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit Nr. 03/L-164;*
  - *Ligji për Shitjen e Banesave për të cilat ekziston e drejta banesore Nr.04/L-061*
- **Zbatimi i rregulloreve të ndërtimit dhe standardeve për kontrollimin e ndërtimit**
  - *Ligji për Ndërtim Nr. 04/L-110*
- **Shfrytëzimi i tokës dhe zhvillimi:**
  - *Ligji për Rregullimin e Tokës Nr. 04/L-040;*
  - *Ligji për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr. 04/L-144*
- **Emërimi i rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike:**
  - *Ligji për Sistemin e Adresave Nr. 04/L-071;*
- **Ofrimi i përkujdesët publik primar shëndetësor:**
  - *Ligji për Shëndetësi Nr. 04/L-125.*
- **Ofrimi dhe mirëmbajtja e parqeve dhe hapësirës publike:**
  - *Ligji për Planifikimin Hapësinor Nr. 03/L-106;*
  - *Ligji për Mbrojtjen e mjedisit Nr. 03/L-025.*
- **Licencimi e shërbimeve publike dhe objekteve, duke përfshirë ato që kanë të bëjnë argëtimin, aktivitete kulturore dhe të lira, ushqimin, strehimin, tregjet, shitësit në rrugë, transportimin lokal publik dhe taksitë:**
  - *Ligji për Transportin Rrugor Nr. 04/L-179;*
  - *Ligji Nr. 04/L-005 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr .2 004/18 për Tregtinë e Brendshme;*
  - *Ligji për Ushqimin Nr. 03/L-016;*
  - *Ligji për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit Nr. 03/L-164;*
  - *Ligji për Teatrot Nr. 04/L-106;*
  - *Ligji për Ansamblin Kombëtar të Këngëve dhe Valleve "Shota" dhe për Ansamblet tjera Nr. 04/L-164;*
  - *Ligji Nr. 04/L-075 për Ndryshimin dhe Plotësimin e ligjit Nr. 2003/24 për Sport;*
  - *Ligji për Fuqizim dhe Pjesëmarrje të Rinisë Nr. 03/L-145.*
- **Shëndetësia Publike:**
  - *Ligji për Shëndetësi Publike Nr. 02/L-78*

- **Mbrojtja e mjedisit:**
  - *Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025*
- **Ofrimi dhe mirëmbajtja e shërbimeve publike dhe shërbimeve komunale, përfshirë furnizimin me ujë,kanalizimin dhe drenazhin e trajtimin e ujërave të zeza, menaxhimin e mbeturinave, rrugëve lokale, transportin lokal dhe skemave të nxehjes lokale:**
  - *Ligji për Mbeturina Nr. 04/L-060;*
  - *Ligji për Transportin Rrugor Nr. 04/L-179;*
  - *Ligji për Ujërat e Kosovës Nr. 04/L-147.*
- **Aktivitetet kulturore dhe të lira.**
  - *Ligji për Teatrot Nr. 04/L-106;*
  - *Ligji për Ansamblin Kombëtar të Këngëve dhe Valleve "Shota" dhe për Ansamblet tjera Nr. 04/L-164;*
  - *Ligji Nr. 04/L-075 për Ndryshimin dhe Plotësimin e ligjit Nr. 2003/24 për Sport;*
  - *Ligji për Fuqizim dhe Pjesëmarrje të Rinisë Nr. 03/L-145;*
- **Promovimin dhe mbrojtjen e te drejtave te njeriut;**
  - *Ligji për Mbrojtje nga Dhuna në Familje Nr. 03/L-182;*
  - *Ligji për Barazinë Gjinore Nr. 2004/2;*
  - *Ligji për Përdorimin e Gjuhëve Nr. 02/L-37;*
  - *Ligji kundër Diskriminimit Nr. 2004/3.*
- **Kompetencat e deleguara**
  - **Shënimet kadastrale:**
    - *Ligji për Kadastër Nr. 04/L-013;*
  - **Regjistrimin e votuesve:**
    - *Ligji për Gjendjen Civile Nr. 04/L-003;*
    - *Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës Nr. 03/L-073*
  - **Regjistrimi Civil:**
    - *Ligji për Gjendjen civile Nr. 04/L-003;*
  - **Mbrojtja e pyjeve që ndodhen në teritorin e komunës në kuadër të autorizimeve të deleguara nga autoriteti qendror, duke përfshirë edhe dhënien e licencave për prerjen e drunjve në bazë të rregullave të miratuara nga Qeveria:**
    - *Ligji Nr. 03/L-153 për Ndryshim Plotësimin e Ligjit Nr. 2003/3 për Pyjet e Kosovës.*
  - **Regjistrimin e Biznesit dhe Licencimin**
    - *Ligji Nr. 04/L-005 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr .2 004/18 për tregtinë e brendshme;*
  - **Distribuimin e pagesave të ndihmës sociale ( më përjashtim te pensioneve).**
    - *Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare Nr. 04/L-081*

#### **Shtojcë 4: Aktet Nënligjore**

- Udhëzimi administrative Nr. 2005/05 Mbi Menaxhimin dhe Shfrytëzimin e Objekteve Publike Komunale.
- Udhëzimi administrativ Nr. 2007/07 për Kufizimin e Veprimtarisë Politike të Shërbyesve Civil Komunal.
- Udhëzimi Administrativ Nr. 2007/06 Për Procedurën e Paraqitjes dhe Vlerësimit të Kërkesave për Transport Humanitar me autobus.
- Udhëzimi Administrative Nr. 2007/08 për Themelimin e Njësive për të Drejtave të Njeriut në Komuna.
- Udhëzimin Administrative Nr. 2008/04 Për Ndryshimin e UA Nr 2005/07 për Zbatimin e Përgjegjësisë të MAPL-së në lidhje me monitorimin dhe mbikeqyrjen e komunave.
- Udhëzimi Administrative Nr. 2008/01 për Ndryshimin e UA MAPL Nr. 2007/04 “ Për formën dhe strukturën e shkresave në komunikim zyrtar të MAPL-së.
- Udhëzimi Administrativ 2008/10 për Organizimin dhe Funksionimin e Komiteteve Konsultative në Komuna.
- Udhëzimi Administrativ Nr. 2008/08 Për Marrëveshjet e Bashkëpunimit të Komunave më fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane.
- Udhëzimi Administrativ Nr. 2008/01 Për Përdorimin e automjeteve Zyrtare në Komuna.
- Udhëzimi Administrativ Nr. 2009/01 për Procedurën e Zgjedhjes dhe Përgjegjësitë e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës.
- Udhëzimi Administrativ Nr. 2009/03 për përdorimin e automjeteve dhe telefonave fiks dhe mobil nga anëtarët e Ekipeve Përgatitore Komunale.
- Udhëzimi Administrativ Nr. 2009/04 për Udhëtime Zyrtare të Anëtareve të EPK-ve.
- Udhëzimi Administrativ Nr. 2010/03 për Procedurën e Përfundimit të Mandatit të Kryetarit të Komunës.
- Udhëzimi Administrativ Nr. 2010/01 për Kufizimin e Kompensimit dhe Marrjes së Pagesës nga Zyrtarët Komunal.
- Udhëzimi Administrativ Nr. 2011/04 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit 2011/01 për Themelimin e Njësive për të Drejtat e Njeriut në Komuna.
- Udhëzimi Administrativ Nr. 2011/03 për Organizimin dhe Funksionimin e Qendrave të Shërbimeve të Qytetareve në Komuna.
- Udhëzimi Administrativ Nr. 2011/02 për Përcaktimin e Procedurave për Zbatimin e Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve.
- Udhëzimi Administrativ Nr. 27/2012 MPB; 03/2012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri dhe Bashkësi.
- Udhëzimi Administrativ Nr. 2012/4 për Vlerësimin e Pasurisë.
- Udhëzimi Administrativ Nr. 2012/3 për Inventarizimin e Pasurisë.
- Udhëzimi Administrativ Nr. 05/2013 për Transparencën në Komuna
- Udhëzimi Administrativ Nr. 2012/1 për monitorimin e KK përmes teknologjisë informative- Teleprezencës.



## Bibliografia/literatura

1. ASK: "Popullsia sipas Gjinisë, Etnicitetit dhe Vendbanimit", Prishtinë, 2011.
2. ASK: "Regjistrimi i Popullsisë dhe Ekonomisë Familjare 2011", Prishtinë, 2012.
3. Banka Botërore: "Evropa Juglindore Raporti i Zhvillimeve Ekonomike", Prishtinë, 2012.
4. Begolli, Fetije "Zyrtare e lartë për Menaxhimin e Buxheteve Komunale në MAPL", Prishtinë, 07.08.2013.
5. Brochure "MEET LOCAL AND REGIONAL SELF-GOVERNMENT IN CROATIA", Publisher by Union of the Association of Cities / Towns and Association of Municipalities of the Republic of Croatia
6. Council of Europe Publishing: "European Charter of Local Self – Government", March 2010.
7. Gerard, Marcou & Hellmut, Wollman: "United Cities and Local Government".
8. Government Publication: "Report of the Local Government Efficiency", Dublin 2010.
9. Këshilli i Evropës: "Karta Evropiane për Vetëqeverisje Lokale". Strasburg, 1991.
10. Kuvendi i Kosovës: "Kushtetuta e Republikës së Kosovës", Prill 2008.
11. Kuvendi i Kosovës: "Ligji Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale", 2008
12. Kuvendi i Kosovës: "Ligji Nr. 03/L-128 për Auditimin e Brendshëm", neni 6.
13. Kuvendi i Kosovës: "Ligji për Financat e Pushtetit Lokal", Prishtinë, 2009.
14. Kuvendi i Kosovës: "Ligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Mbrojtjet e Kosovës", Prishtinë 2003.
15. Ligji Nr. 8652, datë 31.7.2000: "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", (Ndryshuar me ligjin Nr. 9208, datë 18.3.2004), neni 10.
16. Ligji Nr. 02/L-028 për Procedurën Administrative, neni 13.2.
17. Ligji Nr. 04/L-144 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, neni 8.
18. MAPL: "Analizë e të hyrave vetanake në komunitat e Republikës së Kosovës", Prishtinë 2013.
19. MAPL: "Analizë, ndryshimet ligjore të sistemit të vetëqeverisjes lokale në Kosovë", Prishtinë, 2012.
20. MAPL - Analizë: "Regjistrimi i Popullsisë dhe Qeverisja Lokale", Prishtinë 2012.

21. MAPL: *"Raport për periudhën janar/qershor 2013 Vlerësimi i ligjshmërisë së akteve të komunave nga Komisionet Sektoriale të Ministrive të linjës"*, Prishtinë, 2013.
22. MAPL: *"Raporti i funksionimit të kuvendeve të komunave të Republikës së Kosovës", janar-qershor 2013"*, DLMK, 2013, Prishtinë.
23. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal: *"Raport i funksionimit të komunave, janar-dhjetor 2012"*, Prishtinë 2013.
24. MAPL: *"Raporti i të hyrave vetanake për komunat"*, 2008 dhe 2010, Prishtinë.
25. MAPL: *"Raport i monitorimit të komunave të Republikës së Kosovës"*, Prishtinë, Mars, 2011.
26. MAPL: *"Raport i monitorimit të Komunave të Republikës së Kosovës, janar-dhjetor 2012"*, Prishtinë, 2013.
27. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal: *"Raport i monitorimit të komunave të Republikës së Kosovës 2010"*, Mars, 2011.
28. MAPL: *"Raporti i Përgjithshëm i Buxheteve Komunale 2000 – 2013"*, Prishtinë 2013.
29. MAPL: *"Analizë – Vetëqeverisja lokale në këndvështrimin e 'Pakos së Ahtisarit'"*, Prishtinë, Prill, 2013.
30. MAPL: *"Raporti vjetor i punës së MAPL 2012"*, Prishtinë 2013.
31. MAPL: *"Raport i Vlerësimi të Kapaciteteve në Komuna"*, Prishtinë 2011.
32. MAPL: *"Raport për Vlerësimin e Nevojave për Ndërtim të Kapaciteteve në Komuna"*, Prishtinë 2009.
33. MAPL: *"Udhërrëfyes për Sistemin e Monitorimit dhe të Mbikëqyrjes së Komunave"*, Prill, 2012.
34. MASHT: *"Statistikat e Arsimit Parauniversitar 2012/2013"*, Prishtinë, 2013.
35. MBZHR: *"Prodhimtaria bujqësore sipas komunave e shprehur në hektar"*, Prishtinë, 2012.
36. MKRS: *"Lista e Trashëgimisë Kulturore për Mbrojtje të Përkohshme"*, Prishtinë, 2012.
37. MMPH: *"Gjendja e mbeturinave në Kosovë"*, Prishtinë, 2003 – 2004.
38. MMPH: *"Gjendja e Mjedisit në Kosovë"*, Prishtinë, 2004.
39. MMPH: *"Plani Hapësinor i Kosovës"*, Prishtinë 2010.
40. MMPS: *"Puna dhe Punësimi"*, Raporti Vjetor 2012, Prishtinë, 2013.
41. MTI: *"Strategjia Afatmesme e Zhvillimit të Kosovës"*, 2004 – 2008.

42. OECD, SIGMA, BE: *“Assessing Competencies and Functions to Local Self – government, a comparative review”*, UNED, Madrid 2005.
43. OSCE: *“Marrëdhëniet mes pushtetit qendror dhe lokal – Aktet Komunale”*, Shtator, 2009.
44. Përgjigje në shkresë, Nr. 07-468/1, date:02.05.2013 për shqyrtimin e lëndës për procedurat e shpalljes, vlerësimit dhe ri-shpalljes së tenderit për dhënien në shfrytëzim të pasurisë së paluajtshme *“Hotel Park”* në Rahovec.
45. Pollozhani, Bajram & Dobjani, Ermir & Stavileci, Esat & Salihu, Lazim: *“E drejta administrative – aspekte krahasuese”*, 2010.
46. Qendra e Publikimeve Zyrtare: *“Përmbledhje legjislacioni për pushtetin vendor”*, Nëntor 2010.
47. Qendra për Zhvillim Social: *“Anketë me qytetarë serb në Gracanicë, Novobërd dhe Partesh, Gracanicë”*, 2008.
48. Rregullorja Nr.01-2013: *“Për Procedurën e Hartimit dhe Publikimin e Akteve të Komunave”*, neni 18.1.
49. Republika e Kosovës, MAPL: *“Përgjigje në Kërkesë”*, Nr. 07.468/1, datë. 04.2013.
50. Republic of Slovenia, (Official Gazette of the Republic of Slovenia, No. 72/93, 57/94, 14/95, 26/97, 0/97, 10/98, 74/98, 70/00): *“THE LAW ON LOCAL SELF-GOVERNMENT”*, Chapter -III-, Article 21. Shih: nenin 21 dhe nenin 49 të Kapitullit V të Ligjit Mbi Vetëqeverisjen Lokale në Slloveni. No. 72/93, 57/94, 14/95, 26/97, 0/97, 10/98, 74/98, 70/00 *Decision of the Constitutional Court: Official Gazette of the Republic of Slovenia.*
51. Robin Hambleton: *“Modernising Political Management in Local Governments”*, 37 URBAN STUDIES 931, 931 (2000).
52. Stanka Setnikar-Canka, Stane Vlaj, Maja Klun: *“Local Government in Sllovenia”*, Decentralization: Experiments and Reforms, Relationship between the State Administration and Local Government.
53. UNDP: *“Human Development Report”*, Prishtinë, 2002.
54. USAID: *“Hap pas Hapi drejt Përmirësimit të Shërbimeve Komunale”*, Prishtinë, 2012.
55. USAID: *“Sukseset dhe Sfidat e Komunave të Reja”*, USAID, Prishtinë, 2012.